

BIBLIOTEKA

904

C 35.

NERITAN CEKA

# Antigoneia

*Qyteti i dashurisë së parë*

*Migjeni*

904  
C 30

NERITAN CEKA

# *Antigoneia*

*Qyteti i dashurisë së parë*

*Mijeni*

Tiranë, 2009

Përgatiti botimin: Angjelina Ceka

Përpunimi grafik: "Grafika Elzana"

© Shtëpia Botuese *Migjeni*

Në kopertinë:

Pamje e luginës së Drinos nga muret e Antigonesë.

Kisha e Shën Mërisë në Spile, pranë Antigonesë.

ISBN: 978-99956-718-6-0

Shtëpia Botuese *Migjeni*

Rr. Ymer Kurti, 2/2/36, Tiranë

Tel. 00355 42 250 200

## *Falënderim*

Mendimi përtëshkruar këtë libër më lindi gjatë një diskutimi me zonjën Astrid Megard Sollid dhe zotin Ermir Pulaha, mbështetës të një projekti norvegjez për gjallërimin e traditave artizanale të grave të komunës së Antigonesë. Ata më propozuan mbështetjen e një botimi me karakter shkencor-popullor, që do të vinte në dukje vlerat arkeologjike të qytetit antik të Antigonesë dhe do të nxiste vizitat turistike në këtë qendër.

Duhet të pranoj se libri flinte prej kohësh në mendjen time dhe fleta e parë e tij zgjohej sa herë që kujtoja detyrimin ndaj atyre që e prisnin këtë libër prej meje. Në radhë të parë ndaj kujtimit të kolegut tim Dhimosten Budina, i cili në vitet e fundit të jetës nuk gjeti kohën dhe qetësinë për të shkruar një libër të tillë. Më pas ndaj punëtorëve të dikurshëm, me të cilët patëm punuar së bashku në gërmimet e Antigonesë, si dhe ndaj banorëve të krahinës së Lunxhërisë, aq të dhënë pas vlerave kulturore të vendlindjes së tyre. Gjithashtu, punonjësit e Parkut Arkeologjik të Antigonesë nuk ma fshihnin

pakënaqësinë, që unë pata shkruar libra për Apolloninë, Bylisin dhe Butrintin, dhe ende jo për Antigonënë.

Kjo ishte nxitja dhe mbështetja kryesore për t'i hedhur në letër në mënyrë të përbledhur rezultatet e kërkimeve arkeologjike mbi Antigonënë. I shtova atyre edhe një vështrim mbi qendrat antike të luginës, sepse kështu do të kuptohet më mirë rëndësia dhe roli i vetë Antigonesë. M'u desh t'i kushtoj dhe disa faqe jetës së Pirros, themeluesit të këtij qyteti, që arriti të përjetësonë dashurinë e tij të madhe për Antigonën, gruan e tij të parë, me emrin e këtij qyteti.

Le të jetë ky libër një dëshmi mirënjojjeje dhe falënderimi për të gjithë ata që punuan me pasion dhe përkushtim për Antigonënë, apo më mbështetën në botimin e këtij libri: Dhimosten Budina, Engjell Serjani, Dhimitër Condi, Kosta Zaho, Skënder Muçaj, Astrid Megard Sollid, Ermir Pulaha dhe miq e bashkëpunëtorë të tjera.

*Neritan Ceka*

## Një emër në kërkim

Emri i qytetit antik Antigoneia ka tërhequr që herët vëmendjen e udhëtarëve dhe arkeologëve, të cilët i patën kërkuar rrënojat e saj pranë grykave të Antigonesë, siç njiheshin në lashtësi grykate lumi Drino, pranë Ujit të Ftohtë të Tepelenës, ku ato ngushtohen, para se lumi të bashkohet me Vjosën. Konsulli francez pranë Ali Pashës, Fransua Pukëvil, sugjeronte që Antigoneia të kërkohej në fshatin Dragot të Tepelenës. Një tjetër diplomat pranë Ali Pashës, anglezi Uilliam Martin Lik, mendonte se Antigoneia mund të ishte Tepelena, ndërsa bashkatdhetari i tij, Henri Holand, pranonte se grykat e Drinos quheshin në lashtësi grykat e Antigonesë, por qyteti nuk mund të ishte në Gjirokastër, siç shkruante studiuesi grek Meletios.

Një shekull më vonë arkeologët filluan të gjurmonin rrënojat e lashta të luginës së Drinosit dhe të kërkonin midis tyre qytetin e Antigonesë. Në vitin 1913 arkeologu grek S. Evangelidis, duke përfituar nga pushtimi i përkohshëm i trevës së Gjirokastrës nga forcat ushtarake greke, bëri gërmimet e para arkeologjike në kodrën e Jermës. Ai vuri re kudonjështresëdjegieje, qëmbulonterrënojat e gërmuara prej tij dhe nxori përfundimin se ato ishin dëshmi e shkatërrimit të qytetit

nga ushtria e konsullit romak Pal Emili, në vitin 167 p.Kr. Megjithatë, ai mendonte se Antigoneia duhej kërkuar rreth 15 km më në veri, në rrënojat e Paleokastrës. Rreth njëzet vjet më vonë Jermën e vizitoi arkeologu anglez Nikolas Hamond, i cili gjurmoi muret rrethuese të qytetit. Mbi bazën e teknikës së ndërtimit ai i datoi ato si të kohës së sundimit të Pirros, por propozoi të identifikohej atje një qendër ende e panjohur antike, qyteti Hekatonpedon. Në vitin 1952 arkeologu Hasan Ceka gjurmoi vendbanimet e lashta në luginën e poshtme të Drinos, ku i tërhoqi vëmendjen një kështjellë antike pranë fshatit Lekël. Pozita e saj e fortë mbi grykën e Drinosit ishte një argument për H. Cekën se pikërisht aty duhej të ndodhej Antigoneia.

Fatidotëndihmonte arkeologun shqiptar Dhimosten Budina, i cili në vitin 1966 filloi gërmimet arkeologjike në kodrën e Jermës. Në vitin 1969, kur po gërmonte rrënojat e një banese të shek.III p.Kr., ai gjeti 14 tesera të rrumbullakëta prej bronzi, me diametër vetëm 2 cm, por që ishin stampuar me emrin e bashkësisë së qytetarëve të Antigonesë. Ishte e qartë se ai kishte zbuluar qytetin e Antigonesë, të themeluar nga Pirro i Epirit për nder të bashkëshortes së tij të dashur, Antigonës. Dh. Budina i vazhdoi gërmimet

me ndërprerje për rreth njëzet vjet, duke zbuluar një pjesë të qendrës së qytetit të lashtë me rrugët, monumentet publike dhe banesat (fig.1). U sqarua edhe shtrirja e qytetit me fortifikimet dhe sistemin urbanistik. Një numër i madh objektesh të gjetura gjatë gërmimeve shërbyen për të dokumentuar historinë relativisht të shkurtër, por mjaft interesante të qytetit.

Në vitin 2005 gërmimet rifilluan nga një ekspeditë shqiptare-greke e drejtuar nga Dhimitër Çondi dhe Kosta Zahos. Vazhdoi gërmimi i njërsës prej rrugëve kryesore, si dhe i një varri monumental, i zbuluar rastësisht në anën perëndimore të qytetit antik. Pas katër dekada gërmimesh Antigoneia mbetet ende e paprekur në pjesën më të madhe të sipërfaqes së saj, por historia e qytetit antik ka filluar të shkruhet. Kujdesi i vazhdueshëm për monumentet



Fig. 1. Pamje e qendrës së qytetit antik të Antigonesë.

e zbuluara nga gërmimet dhe shpallja e Parkut Arkeologjik të Antigonesë, e kanë bërë atë një qendër që tërheq vazhdimisht vizitorë.

# Pirro dhe Antigona

Qyteti i Antigonesë është një përjetësim i dashurisë së Pirros së Epirit për gruan e tij, Antigonën. Një histori e shkurtër e tyre do të na ndihmonte për të kuptuar më mirë rrethanat në të cilat u krijua dhe lulëzoi ky qytet.

## Legjendat

Pirro zbriste nga dinastia molose e Eakidëve, e cila mbretëroi në Epir deri në vitin 232 p.Kr., kur u vendos republika. Emri i dinastisë vinte nga Eaku, gjyshi i Akilit, mbret legjendar i ishullit të Eginës në Greqi. Sipas legjendës, pas vrasjes së Akilit gjatë rrithimit të Trojës, vendin e tij në luftë e zuri i biri, Neoptolemi, i quajtur Pirro, për arsyen e flokëve të tij të kuqe (nga greqishtja e vjetër **pyrr** – zjarr). Në Trojë ai u dallua si luftëtar i pamëshirshëm, duke vrarë edhe Priamin, kur po falej në altar. Ky mëkat do t'i ndiqte eakidët deri në fund të dinastisë së tyre.

Pas rrënimit të Trojës Pirro Neoptolemi mori si robër vëllanë e Hektorit, Helenin, të dalluar për profecitë e tij, si dhe Andromakën, të venë e Hektorit. Në vend që të kthehej në Eginë, ai shkoi në Epir, ku themeloi dinastinë Pirride, apo Eakide. Biografi antik i Pirros, Plutarku, tregon se

deri atëherë Epiri qeverisej nga një dinasti e themeluar nga Fetoni, i cili kishte ardhur atje së bashku me Pellazgun. Pasardhësit e tyre kishin themeluar edhe faltoren e Dodonës, kushtuar Zeusit. Pirro Neoptolemi nderohej si figurë hyjnore në Epir dhe në gjuhën vendëse quhej Aspetos. Ky ndajshtrim është shpjeguar me shqipen “i shpejtë”, një atribut i njojur për Akilin (këmbëshpejtë).

Sipas historianit romak, Justinit, Pirro Neoptolemi u vendos në Epir, pasi kishte humbur mbretërinë e trashëguar nga i ati për shkak të largimit në luftën e Trojës. Në fillim banorët u quajtën pirridë dhe më pas epirotë. Justini tregon më tej se kur Pirro Neoptolemi vajti për të pyetur orakullin e Dodonës, rrëmbeu Lanasën, bijën e Herakliut. Më pas ai u vra nga Oresti, biri i Agamemnonit, në Delf, në mes të altarëve të perëndisë Apollon. Ndërkohë, Helenit, birit të Priamat, ai i kishte dhënë mbretërinë e kaonëve dhe e kishte martuar me Andromakën, të venë e Hektorit.

Shkrimitari i lashtë helen, Apollodori, na jep një histori më të ngatërruar, sipas së cilës Neoptolemi "...u nis më këmbë bashkë me Helenin për te molosët; varrosi Foiniken, e cila vdiq rrugës. Si fitoi betejën, u bë mbret i molosëve dhe lindi nga Andromaka

Molosin. Kurse Heleni ndërtoi në Molosi një qytet dhe banoi aty. Neoptolemi i dha atij për grua të emën, Deidamenë”.

Poeti romak, Virgjili, në veprën e tij “Eneida” na ka pëershkuar një finale të lumtur të këtij shtegtimi trojan, kur në atë qytet krejt të ngjashëm me Trojën, që është Butroti, Enea u prit mbretërisht nga Heleni dhe Andromaka.

Kjo nuk është historia e vetme trojane në trojet ilire-epirote. Bylinët, në trevën e sotme të Mallakastrës, krenoheshin se zbrisnin gjithashtu nga Pirro Neoptolemi dhe në monedhat e tyre prej bronzi e paraqisnin kokën e tij me përkrenare (fig.2). Në bregun tjetër të Aosit (Vjosës), amantët ilirë pretendonin se ishin pasardhës të luftëtarëve abantë, nga ishulli i Eubesë, që kishin zbritur aty pas kthimit nga Troja. Vetë molosët do ta theksonin këtë traditë, duke përsëritur emrat legjendarë në dinastinë e tyre me vetë mbretin Pirro, motrën e tij, Deidamenë, babanë, Eakidin, djalin e xhaxhait, Neoptolemin, etj.

## Eakidët

Në kohët historike si mbret i parë i eakidëve njihet Tharypsi, që sundoi rrëth viteve 430–390 p.Kr. Sipas Plutarkut ai “...ishte i pari që u dallua, sepse zbukuroi qytetet sipas zakoneve greke, u dha dituri dhe ligje të mira...”. Justini sqaron se Tharypsi kishte studiuar në Athinë dhe “...qe i pari që rregulloi ligjet, kuvendin e magjistratët



Fig. 2. Monedhë e Bylisit me kokën e Neoptolemit.

e përvitshëm dhe formën e qeverisjes”. Në oborrin e tij mbretëror në Pasaron, u ftua Euripidi për të shfaqur dramën “Andromaka”, ku tregohej përndjekja e saj nga gruaja e Pirro Neoptolemit, derisa u martua me Helenin.

Biri i Tharypsit, Alketasi, kishte vazhduar përpjekjet për ta bërë mbretërinë molose një faktor të rëndësishëm politik. I dëbuar për disa vjet nga froni ai u kthyte përsëri në vitin 385 p.Kr. në aleancë me Dionisin e Sirakuzës dhe mbretin Bardhyl të Ilirisë. Në vitin 375 p.Kr. Alketasi u bë anëtar i Lidhjes së Dytë Detare të Athinës. Djali i tij, Neoptolemi, zgjeroi kufijtë e mbretërisë, duke përfshirë edhe një pjesë të Thesprotisë. Rreth vitit 360 p.Kr. atë e

pasoi në fron Arrybasi, i cili nxitoi të lidhej me mbretërinë e fuqishme maqedone. Kjo aleancë u përforcua në vitin 357 p.Kr. me martesën e mbesës së tij Olympisë, me Filipin II të Maqedonisë, nga e cila lindi Aleksandri i Madh. Kjo nuk e pengoi Filipin që në 343 p.Kr. të sulmonte mbretërinë molose, të rrëzonte Arybasin dhe të vendoste si mbret vëllanë e Olympisë, Aleksandër Molosin. Nën sundimin e tij u përfshinë edhe kaonët dhe mbretëria u quajt "Aleanca Epirote". Është e njohur aventura ushtarake e Aleksandër Molosit në Italinë e Jugut, ku ai u vra në betejën e Pandosias në vitin 330 p.Kr. Sa mori vesh vdekjen e të vëllait Olimpia e la Maqedoninë dhe zuri froni molos në Pasaron. Ajo thirri pranë saj djalin më të vogël të Arrybasit, Eakidin, dhe i forcoi lidhjet midis molosëve, kaonëve dhe thesprotëve. Pas vdekjes së Aleksandrit të Madh më 323 p.Kr., Olimpia ndërhyri në grindjet për froni maqedon dhe krijoi Simahinë Epirote, si aleancë ushtarake kundër Maqedonisë. Në Dodonë u strehua gruaja e Aleksandrit të Madh, Roksana, së bashku me djalin, Aleksandrin e Ri, që e kishin fejuar me vajzën e Eakidit, Deidamenë. Eakidi u vu në krye të ushtrisë epirote, e cila u fut në Maqedoni dhe rivendosi në froni maqedon Aleksandrin. Atij iu desh të ndërhynte përsëri në mbrojtje të Olimpisë dhe Aleksandrit, që u rrethuan në kryeqytetin e Maqedonisë, në Pidna, nga pretendenti për froni, gjenerali maqedonas

Kasandër. Ndërhyrjet e kushtueshme në grindjet për froni maqedonas shkaktuan pakënaqësi ndaj Eakidit në Epir. Një kryengritje në vitin 317 p.Kr., e mbështetur edhe nga mbreti maqedonas Kasandër, e rrëzoi atë nga froni, në favor të nipit të tij, Neoptolemi II. Djali i Eakidit, Pirro, ishte vetëm dy vjeç, kur u shpëtua në çastin e fundit nga dy fisnikë molosë. Plutarku tregon se në fillim ata u drejtuan për në qytetin Megara të Maqedonisë, të ndjekur nga kalorësit e mbretit Kasandër. "...Dielli posa kishte perënduar dhe ata menduan se kishin shpëtuar, kur u gjendën përparrë lumit të qytetit, i cili dukej shumë i rrëmbyer. Kur provuan të hidheshin në anën tjeter, u duk se ishte e pamundur, sepse shiu i madh që kishte rënë ato ditë e kishte bërë lumin të thellë, të egërsuar dhe të turbullt. Meqë vetë errësira e bënte kapërcimin më të rrezikshëm, vendosën që të mos e kalojnë, pa pasur një ndihmë tjeter, meqë kishin foshnjën dhe gratë. Për fat të mirë atë çast panë disa njerëz përtej lumit, nga të cilët kërkuan ndihmë dhe i treguan Pirron që qante me të fortë. Por njerëzit përtej nuk kuptonin asnjë fjalë prej zhurmës së lumit, derisa njëri nga këta mendoi një mënyrë tjeter më të mirë. Ai hoqi lëvoren e një shelgu, shkroi në të kërkësën për ndihmë dhe rrezikun e foshnjës, që po e ngrinin lart ta shikonin. Pastaj mbështolli lëvoren e shelgut në një gur dhe e hodhi përtej lumit. Njerëzit përtej kuptuan se çfarë

po ndodhte me foshnjën; pa humbur kohë prenë drurë me të shpejtë, i lidhën bashkë dhe u hodhën në anën tjetër të lumit. Si për çudi, njeriu i parë që arriti dhe mori Pirron në duar, quhej Akil. Pastaj të gjithë kaluan lumin. Pasi shpëtuan prej ndjekësve dhe prej lumit, të arratisurit arritën në Iliri, te mbreti Glaukias. E gjetën atë në shtëpi, bashkë me të shoqen dhe e vendosën fëmijën përdhe në mes tyre. Mbreti, atëherë, ra në mendime, sepse kishte frikë nga Kasandri, që ishte armik i Eakidit dhe për një kohë të gjatë po mendohej në heshtje. Ndërkohë Pirro vetvetiu u afrua këmbadoras deri te mbreti dhe si kapi me dorë rrobën dhe u ngrit më këmbë, duke u mbajtur në gjunjët e tij, e bëri të qeshë njëherë, por pastaj i shkaktoi dhembje, duke qëndruar si një lutës që derdh lot. Disa thonë se ai nuk ra ndër këmbët e Glaukias, por duke zënë me dorë altarin e perëndive, qëndroi pranë tij dhe e pushtoi dhe kjo iu duk Glaukias diçka hyjnore. Prandaj menjëherë ia dorëzoi Pirron së shoqes, me urdhër që ta rriste bashkë me bijtë e tjerë...”.

Justini shkruan se Beroja, bashkëshortja e mbretit Glaukia, ishte nga familja e Eakidëve. Kasandri i kërkoi Glaukias ta dorëzonte Pirron në këmbim të 200 talenteve, një peshë e përgjithshme argjendi prej rreth 520 kg, por ai refuzoi edhe nën kërcënimin e luftës.

## Pirro – hapat e parë

Më 307 p.Kr., kur Pirro ishte dymbëdhjetë vjeç, Glaukiasi e ktheu atë në froni e Epirit në krye të një ushtrie ilire. Do të qëndronte në froni vetëm pesë vjet, sepse kur kishte shkuar në Iliri, në dasmën e djalit të Glaukias, Perseut, mbreti i Maqedonisë, Kasandri, u dynd me ushtrinë e tij në Epir. Në froni molos u vendos si mbret kukull Neoptolemi, njëri nga kushérinjtë e Pirros.

Pirro u arratis përsëri dhe hyri në shërbim të Demetër Poliorketit, njërit nga strategët më të njohur të kohës, i cili ishte bashkëshort i Deidamesë, motrës së Pirros. Më 301 p.Kr. ai u dallua në betejën e Ipsos, ku ushtria e Demetrit u thye nga një koalicion i pasardhësve të Aleksandrit. Pirro u dërgua si peng në oborrin e mbretit Ptoleme I të Egjiptit, ku u trajtua me bujari. Qëndrimi gjashtëvjeçar në Egjipt i dha një drejtim të ri jetës së Pirros. Sipas dëshmisë së Plutarkut, "...këtu i dha Ptolemeut prova të mëdha të forcës dhe guximit të tij në gjueti dhe në ushtrimet gjimnastikore. Si e pa që Berenika kishte fuqi të madhe dhe nga virtuti e urtësia ia kalonte grave të tjetra të Ptolemeut, iu tregua asaj shumë i respektueshëm. Meqenëse ishte i shkathët përtëbërë përvete më të fortët, ashtu sikurse urrente frikacakët dhe, mbi të gjitha, ishte i sjellshëm dhe i urtë në jetë, u zgjodh midis princave të tjerë të rinj, për t'u martuar me

## Pirro dhe Antigona

Antigonën, njëren prej vajzave të Berenikes, që e kishte me Filipin, para se të martohej me Ptolemeun. Kjo martesë e rriti më tepër emrin e Pirros. Duke pasur edhe ndihmën e gruas së tij të mençur, Antigonës, ia arriti të mbledhë të holla dhe ushtri dhe u nis për në Epir për të rimarrë fronin. Këtu u prit me gëzim nga një shumicë e madhe populli, që e urrenin Neoptolemin, i cili sundonte në mënyrë mizore dhe të egër".

Justini dëshmon se ky rikthim në pushtet, i vitit 297 p.Kr., ishte pothuaj një pushtim, sepse Ptolemeu i Egjiptit i kishte dhënë mevete Pirros "...pesëmijëkëmbësorë, katërmijë kalorës dhe pesëdhjetë elefantë me një afat jo më të gjatë se dy vjet". Sipas Plutarkut, Antigona del të ketë luajtur një rroll të veçantë në organizimin e kësaj ndërmarrje dhe, me të vërtetë, ajo nuk ishte një vajzë e zakonshme. Ajo duhet të ketë qenë moshatare me Pirron dhe ishte bijë e Berenikes dhe e Lagut, një nga gjeneralët e Aleksandrit me origjinë nga krahina ilire e Eordesë. Pas vdekjes së burrit, Filipit, Berenika u largua për në Aleksandri si shoqëruese e tezes së saj, Euridikes, që u martua me mbretin Ptoleme I, themelues i dinastisë së famshme të Lagidëve, apo Ptolemejve, e cila e sundoi Egjiptin deri në kohën e Kleopatrës. Ishte fillimi i një historie të ngatërruar, sepse Ptolemeu ishte vëllai me nënë tjetër i Berenikes. Pak vjet më vonë ajo u martua vetë me Ptolemeun dhe pati edhe

dy fëmijë të tjerë, Arsinoen dhe Ptolemeun, i quajtur Filadelfi. Kështu, nga vëllezërit e Antigonës, Magasi, biri i Filipit, u bë mbret i Kirenës në Libinë e sotme, ndërsa Ptoleme Filadelfi trashëgoi fronin e të jatit në Egjipt. Motra, Arsinoe, do të martohej me mbretin e Trakës, Lisimahun, por pas vdekjes së tij do të kthehej në Egjipt për t'u martuar me të vëllanë, Ptoleme Filadelfin. Vetëm jeta e Antigonës do të ishte më e thjeshtë: ajo vdiq në Epir rrëth vitit 295 p.Kr., duke lënë pas një djalë të quajtur Ptoleme.

## Pasardhës i Aleksandrit të Madh

Në fillim Pirro bashkësundoi me Neoptolemin, por kur u njoftu se ai po përgatiste një komplot kundër tij, e vrau atë. Në një kohë të shkurtër jo vetëm siguroi kufijtë e Epirit, por edhe ndërhyri në luftërat për fronin e Maqedonisë, duke pretenduar edhe fronin e saj. Më 294 p.Kr. u ndesh atje me mbrojtësin e tij të dikurshëm Demetër Poliorketin, të cilit i kishte vdekur ndërkokë e shoqja, motra e Pirros. Në një radhë sulmesh ia shkëputi Maqedonisë krahinat kufitare me Epirin, një pjesë të Ilirisë së Jugut deri në Apolloni, Akarnaninë dhe koloninë e pasur korinthase të Ambrakisë. Më 287 p.Kr. mbreti Demetër u fut në Epir me një ushtri të fortë, por ndeshi në qëndresën e Pirros. Plutarku e përshkruan atë betejë me ngjyra homerike: "Pantahu, i cili për trimëri, shkathësi dhe

forcë fizike ishte, padyshim, komandanti më i mirë i mbretit...e ngacmonte Pirron, duke e thirrur në dyluftim. Edhe Pirro, të cilinuk ia kalonte asnjë nga mbretërit për forcë dhe guxim dhe që donte ta bënte familjare famën e Akilit, më tepër për trimëri sesa për farefisni, shkonte drejt Pantauhut në radhët e para të ushtrisë. Në fillim luftuan me heshta. Pastaj, si u përleshën, përdorën shpatat me mjeshtëri dhe forcë. Pirro mori një plagë, por i shkaktoi armikut dy, një në kofshë dhe tjetrën në qafë dhe e rrëzoi atë përtokë, por nuk mundi ta vrasë, se miqtë e tij ja hoqën nga duart. Epirotët, krenarë përfitoren e mbretit të tyre dhe me admirim të madh për trimërinë e tij, u sulën kundër këmbësorisë maqedonase, e thyen dhe duke i ndjekur ata që po iknin, vranë shumë prej tyre dhe zunë të gjallë pesëmijë vetë”.

Pirro marshoi me ushtrinë e tij drejt lindjes, duke pushtuar një pjesë të Maqedonisë dhe Thesalinë. Tani e quajti të drejtë të ulej në froni e kushërit të tij, Aleksandrit të Madh, dhe të mbante me krenari një përkrenare të ngjashme me të atij. Plutarku shkruan se ajo dallohej nga zbukurimi me pendë të larta dhe me brirë dhie. Një përkrenare të ngjashme do të mbante shumë shekuj më vonë Skënderbeu (fig.3), që e quante veten Aleksandër (turqisht Iskander) dhe epirot.

Pasi bëri një paqe me Lisimahun e Thrakisë Pirro shkoi në Athinë dhe u ngjit në Akropol, për t'i bërë nderimet perëndeshës

Athina. Plutarku shkruan se “...si zbriti që andej po atë ditë, falënderoi popullin për besimin dhe mirëdashjen që shprehën për të, por i këshilloi të mos lejojnë asnjë mbret që të futet në qytetin e tyre...”. Ishte një dyshim i drejtë për mbretërit, sepse, siç shkruante Justini, nuk kaloi shumë kohë dhe “ ...midis Lisimahut dhe mbretit Pirro, të cilët pak më parë vepruan si aleatë kundër Demetrit, filluan grindjet, një e keqe e zakonshme midis barbarëve, dhe



Fig. 3. Përkrenarja e Skënderbeut.

## *Pirro dñe Antigona*

plasi lufta". Lisimahu e mundi Pirron dhe pushtoi Maqedoninë. Pausania shkon edhe më larg, kur na njofton se rreth vitit 285 p.Kr. "Lisimahu sulmoi Epirin në mungesë të tij dhe shkatërrroi varret e mbretërve epirotë, që ishin të përbashkët". Sigurisht, Pausania bën fjalë për lidhjen dinastike të Pirros me Olimpinë, nënën e Aleksandrit të Madh, ndonëse Lisimahu në fillim të karrierës së tij kishte qenë vetëm një truprojë i mbretit maqedonas. Trimëria e treguar në

betejat e para përhapi menjëherë famën e Pirros dhe siç shkruante Plutarku "... pamjen, shpejtësinë dhe shkathësinë e tij e gjykonin të ngjashme me atë të Aleksandrit dhe dukej sikur shikonin tek ai pothuaj hijen dhe një përsëritje të gjallë të sjelljes dhe fuqisë së tij në luftë. Ndërsa mbretërit e tjerë kërkonin ta ngjasonin në veshjen e purpurt, në gardën personale dhe në qafën e mënjanuar, vetëm Pirro i afrohej në luftë dhe në trimërinë personale" (fig.4-5).



Fig. 4. Aleksandri i Madh i Maqedonisë. Mozaik i shek.I p.Kr.




Fig. 5. Pirro. Portret i gjetur në Herkulanum. Museo Nazionale, Napoli.

### Burrë shteti dhe diplomat

Kjo ishte koha që Pirro tregoi edhe aftësitë e veta në administrimin e shtetit, ku ruajti institucionet tradicionale të tri krahinave të mëdha epirote: Molosisë,

Thesprotisë dhe Kaonisë. Pushteti i tij kufizohej nga mbledhja e përgjithshme e popullit dhe një përfaqësues i përhershëm i saj, i cili qëndronte pranë mbretit. Me gjithë nevojën e vazhdueshme për të holla, Pirro nuk preu asnijëherë monedha epirote me emrin e tij, sepse kjo e drejtë ushtrohej në emër të gjithë popullit. Që në vitet e para të sundimit Pirro ndërtoi dy qytete të mëdha: Bereniken në Thesproti dhe Antigonënë në Atintani. Në këtë mënyrë ai donte të përjetësonte edhe emrat e dy grave më të rëndësishme në jetën e tij. Pirro e shpërndguli oborrin mbretëror nga Pasaroni malor në koloninë korinthase të Ambrakisë, duke e kthyer në një kryeqytet të ndritshëm, siç dëshmon Polibi ("...pikturat dhe shtatoret ishin të shumta sepse Ambrakia kishte qenë seli e Pirros...") dhe Straboni ("...lulëzonte edhe më parë, por e stolisi dhe e zbukuroi në mënyrë të veçantë mbreti Pirro").

Pirro e transformoi faltoren e thjeshtë të Dodonës në një qendër të rëndësishme kulti. U ndërtua një tempull i ri pranë lisit të famshëm dhe një radhë portikësh përvendosjen e dhuratave. Pranë tyre u ndërtua një teatër për rrëth 20000 spektatorë dhe stadiumi për zhvillimin e garave atletike.

## *Pirro dhe Antigona*

Ky nuk ishte trashëgimi i vetëm nga mbreti molos, i cili u kujdes edhe për blegtorianë, si dega kryesore e ekonomisë epirote. Sipas Plinit "...gjedhet epirote lëvdohen së tepërmi. Kjo racë, sikur thonë, i detyrohet kujdesit të Pirros. Ai e arriti duke mos lejuar ndërzimin e femrave para se të mbushnin katër vjeç". Është përsëri Plini që i kushtonte atij cilësi mrekullibërëse: "... i tillë ka qenë gishti i madh i këmbës së djathtë të Pirros që shëronte me prekje shpretkën. Ky gisht nuk u dogj me trupin dhe u vendos në një kamare në tempull". Edhe sipas Plutarkut, Pirrua nuk kishte shumë dhëmbë, si gjithë njerëzit e tjerë; dhëmbët e sipërm i kishte të ngjitur si një i vetëm. Ai kishte aftësinë të shëronte shpretkën e njerëzve duke rënduar mbi organin e sëmurë me këmbën e djathtë, pasi therte një gjel të bardhë. Shërimi bëhej pa shpërblim, përveç gjelit që i mbetej mbretit. Edhe Plutarku shkruan se gishti i madh i këmbës së djathtë kishte cilësi hyjnore dhe mbas djegies së trupit të tij u gjendi patretur. Nga shkrimitari romak Eliani është ruajtur kujtimi i shqiponjës së Pirros. Ajo ushqehet nga vetë mbreti, të cilit i pëlgente ta quanin edhe atë vetë shqiponjë.

Ardhja në Epir solli fat për Pirron, por jo për Antigonën. Ajo duket të ketë vdekur dy vjet pasi u bë mbretëreshë, rreth vitit 295 p.Kr., duke lënë pas një djalë dyvjeçar, Ptolemeun. Kjo mund të ketë qenë koha që Pirro vendosi të ndërtojë Antigonën në

Atintaninë e Sipërme. Qyteti shënonët një themelim krejt të ri, duke marrë atë rëndësi që kishte më parë një kështjellë e ngritur në shek.IV p.Kr. në kodrën e Melanit, pranë Nepravishës. Synimi i Pirros nuk ishte vetëm përjetësimi i kujtimit të gruas së tij të dashur, por edhe kontrolli i rrugës kryesore që lidhte Epirin me Ilirinë përmes luginës së Drinos. Përkëtë qëllim Pirro ndërtoi edhe një kështjellë atje ku lugina ngushtohet pranë fshatit Lekël të Tepelenës dhe që në lashtësi u quajtën grykat e Antigonesë. Plutarku na informon se nostalgjia e Pirros për Antigonën nuk vazhdoi gjatë. "Pas vdekjes së Antigonës ai u martua me shumë gra për arsyë shtetërore dhe për të rritur fuqinë e tij. Në fakt mori për grua të bijën e Audoleonit, mbretit të Paionëve; Birkenën, të bijën e Bardhylit, mbretit të ilirëve; dhe Lanasën, të bijën e Agathoklit të Sirakuzës, e cila i solli si prikë qytetin Korkyra të pushtuar prej Agathoklit. Nga Antigona pati të birin, Ptolemeun, nga Lanasa Aleksandrin dhe nga Birkena Helenin, më të riun. I rriti të gjithë trima dhe të guximshëm për armë, duke i edukuar që në fëmijëri me ndjenja fisnike". Në një vend tjetër Plutarku na thotë se Pirro i pati dërguar djemtë për t'u edukuar në Spartë.

Martesa më e palumtur e Pirros doli të ishte ajo me princeshën greke Lanasa. Sipas Justinit, Lanasa u bë xhelozë për arsyë se Pirro i përkushtohej më shumë

grave barbare. Ajo e braktisi mbretin epirot pér t'u martuar me armikun e tij Demetér Poliorketin, duke i dorëzuar atij Korkyrën.

### Ambicjet pértej mundësive

Themelimi i Antigonesë dhe martesat lidheshin me planet e Pirros pér të zgjeruar mbretërinë epirote drejt tokave ilire dhe, më tej, pértej Adriatikut. Rreth vitit 282 ai pati pushtuar kryeqytetin e ilirëve, në kështjellën e Gurëzezës, pranë Cakranit. Natyralisti i njohur romak, Plini, shkruante se Pirro kishte pasur idenë që të ndërtonte një urë atje "...ku ndahen deti Jon dhe Adriatiku dhe ku kalimi pér në Itali është më i shkurtër; përballë është qyteti i apolloniatëve...". Ka mundësi që Pirro përqendroi aty forcat në vitin 281 p.Kr. pér t'u hedhur në Itali, i ftuar nga qyteti i Tarentit (sot Taranto). Ai e kaloi Adriatikun me një forcë prej 25000 këmbësorësh, 3000 kalorësish dhe 20 elefantësh. Sipas Justinit, "pér të ruajtur shtetin ai la të birin e tij pesëmbëdhjetëvjeçar, Ptolemeun; dy bijtë më të vegjël, Aleksandrin dhe Helenin, që të mos e merrte malli, i mori me vete".

Njihet fitorja e parë e Pirros kundër romakëve, veçanërisht efekti i parë i sulmit me elefantët (fig.6), por edhe humbjet e mëdha që pësoi në betejën e Heraklesë më 280 p.Kr., që mbeti në histori " fitore si e Pirros". Pas kësaj ai u afrua me ushtrinë e tij fare pranë Romës, ku dërgoi pér të bërë



Fig. 6. Ushtarët e Pirros mbi elefantë. Pikturë e një vazoje italike rrëth vitit 280 p.Kr.

paqe këshilltarin e tij, Kineasin, pér të cilin Plutarku thotë se "...ishte i fortë në të folur dhe i vetmi që mund të krahasohej pér këtë me Demostenin". Romakët nuk u lëkundën nga gojëtaria e tij dhe as nuk pranuan dhuratat e ofruara, duke i thënë sipas historianit bizantin Zonara: "Ti megjithëse je shumë i pasur, je dhjetëmijë herë më i varfër. Në qoftë se do të ishe i kënaqur nga ato që ke, nuk do të dëshiroje më tepër dhe nuk do të kishe lënë Epirin, as vendet e tjera që ke dhe të vije këtu ". Justini tregon se Kineasi u kthyte duarthatë dhe "...i pyetur nga mbreti: "Po Roma si ishte? - ai u përgjigj:

## *Pirro dhe Antigona*

- Pashë qytetin e mbretërve”.

Pas një fitore të dytë edhe më të vështirë në Auskulum, Pirro vendosi të hidhej në Sicili në ndihmë të qytetit të Sirakuzës, që luftonte kundër kartagasve. Historiani sicilian, Diodori, i cili e përshkroi atë fushatë, shkruante se fitoret e Pirros “...ishin fitore kadmike: të mundurit nuk ishin mposhtur plotësisht për sa i përket fuqisë së tyre dhe ngadhënjyesit kishin pësuar kaq humbje dhe shkatërrime sa edhe të mundurit”. Ky ishte një vlerësim i ngjashëm me Plutarkun që shkruante se Pirro "...di të hedhë zaret, por nuk di si ta shfrytëzojë fitoren dhe gjithnjë humbet”. Ky shkrimtar na ka përcjellë edhe një bisedë të mbretit me këshilltarin e tij besnik. Pyetjes së Kineosit, nxënës i oratorit Demosten, se çfarë do të bënin pasi të kishin pushtuar Italinë, Sicilinë, Kartagjenën, Libinë, Maqedoninë, Pirro iu përgjigj: “Do të prehem gjithë ditën dhe do të dëfrejmë me biseda, dhe zemrat tona do të gëzojnë me të pira të këndshme”. Atëherë Kineasi i tha: “Çfarë na ndalon të dëfrejmë e të pimë që tani? Ky privileg është i yni dhe i kemi në dorë pa ndonjë mundim të gjitha ato që shpresojmë t'i marrim me rrezik, me gjak dhe duke mjeruar të tjerët dhe veten tonë”.

Diodori, që e përshkruan fushatën e Pirros në Sicili, duket se ruante përshtypjet e një ndërmarrjeje të jashtëzakonshme, kur na thotë se anija mbretërore kishte nëntë sërë lopatash, ndërsa e gjithë flota

e tij kishte më shumë se 200 anije. Pas marrjes së Sirakuzës dhe Agrigentit Pirro “... depërttoi në tokat që mbanin kartagosit me një ushtri prej 30000 këmbësorësh, 1500 kalorës dhe disa elefantë...qyteti i Erykinës mbrohej nga një garnizon i fortë kartagas. Mbreti që donte të mbulohej me lavdi dhe të shkonte në gjurmët e Herakliut, hipi i pari mbi muret dhe atje, duke luftuar trimërisht, i bëri copë të gjithë kartagosit që vërsuleshin mbi të”. Edhe fushata siciliote nuk qe e lumtur për Pirron. Flota e tij u thye nga ajo kartagase pranë Lilibeumit dhe aleatët e tij sirakuzas u revoltuan nga mundimet e luftës. Apiani shkruante se Pirro ndaloi mbledhjet e dëfrimet, qytetarët i futi në stërvitje luftarake, në punë dhe i ngarkoi me taksa. Ai arriti të mbyllte edhe dyert e qytetit që popullsia të mos arratisëj prej tij. Dionisi i Halikarnasit shkruante se Pirro sillej si despot dhe arriti deri atje, sa grabiti thesaret e tempullit të Persefonës. Sendet u transportuan për në Epir, por flota u shkatërrua nga shtrëngata dhe thesaret u shpërndanë në ranishtat e lokërve. “Mbreti i trembur nga kjo - vazhdon ai, i ktheu të gjitha dhuratat dhe thesarin e perëndeshës, duke iu lutur që ta zbuste këtë zemërim...Ai e pësoi nga zemërimi i perëndeshës që kishte fyer, siç e tregon shkrimtari Proksen. Këtë Pirrua e ka pasur edhe vetë parasysh dhe e shkruan në kujtimet e tij”.

Në vitin 276 p.Kr. Pirrua la Sicilinë për të rifilluar luftën me romakët. Një vit më vonë ai u thye keqas në Malventum, që në latinisht do të thotë "era e keqe". Konsulli fitimtar romak, M. Dentatus, e quajti qytetin Beneventum (era e mirë). Pas disfatës Pirro u kthye në Epir vetëm me një të tretën e forcave me të cilat ishte nisur, duke ja lënë mbrojtjen e Tarentit të birit nga Brikena, Helenit.

### Vitet e fundit

Në Epir gjeti djalin nga Antigona, Ptolemeun, që ishte burrëruar dhe kishte thyer mbretin maqedon Antigon Gonatën, birin e Demetër Poliorketit, duke ripushtuar Korkyrën. Justini shkruante se "Ptolemeu ishte kaq i rrëmbyer, sa që qytetin Korkyra e mori me 60 ushtarë; po ky në një luftë detare u hodh nga një varkë në një anije me pesë sërë lopatash vetëm me pesë ushtarë dhe e kapi këtë anije".

Pirro nuk ishte kthyer nga Italia për të pushuar. Mbasit u kthye në Epir me tetëmijë këmbësorë dhe pesëqind kalorës - shkruan Plutarku - duke mos pasur mjete të mjaftueshme për t'i ushqyer, kërkonte shkak për luftë, për t'i siguruar këto". Më 273 Pirro sulmoi Maqedoninë dhe shkatërrroi ushtrinë e fortë të mercenarëve galë të mbretit Antigon Gonata, biri i Demetër Poliorketit. Ashtu si dikur me vetë Demetrin, falanga maqedone u bashkua

me Pirron, "...për arsyse se maqedonasit kërkonin t'ishmangeshin përpjekjes dhe luftës me të. Ai, atëherë, duke ngritur dorën e djathët dhe duke i thirrur komandantët dhe oficerët në emër, tërhoqi pak nga pak me vete të gjithë këmbësorët e Antigonit, i cili iku...". Plutarku e vazhdon tregimin, duke thënë se Pirro e quajti atë si fitoren më të madhe të tij dhe në shenjë mirënjojje ia dhuroi trofetë më të vlefshme të luftës tempullit të Athinasë Itone pranë Larisës, në Thesali, me mbishkrimin:

*"Pirro Molosi ia dhuron Athinasë Itone  
Këto mburoja, që ua hoqi galatëve të forte  
Pasi shkatërroi gjithë ushtrinë e Antigonit;  
Dhe nuk është kjo një çudi e madhe,  
Sepse aiakidët janë edhe tani luftëtarë,  
Siç kanë qenë në të kaluarën".*

Pausania, një shkrimtar helen që pati shkruar një libër mbi faltoret e famshme të kohës, sqaron se mburojat maqedonase të kapura në betejë Pirro i vendosi në tempullin e Zeusit, në Dodonë, me mbishkrimin:

*"Këta dikur plaçkitën Azinë plot ar.  
Këta edhe Heladën deshën ta robërojnë;  
Tani pranë shtyllave të tempullit të Zeusit,  
Si jetime varet plaçka e Maqedonisë  
mburracake".*

Kjo ishte fitorja e fundit e madhe e Pirros, pas së cilës fati u kthye kundër komandantit të madh. Diodori besonte se kjo ndodhi për shkak të grabitjes së varreve të mbretërve maqedonas nga mercenarët galë, të cilët

## *Pirro dhe Antigona*

Pirro i vendosi në kryeqytetin e vjetër të Maqedonisë, në qytetin Aiga.

I thirrur për ndihmë nga mbreti i Spartës, Kleonymi, që po luftonte kundër Antigon Gonatës, Pirro iu drejtua Peloponezit me 25000 këmbësorë, 2000 kalorës dhe 24 elefantë. Kjo forcë e madhe ngjalli dyshimin e spartanëve, se "...qëllimi i Pirros nuk ishte që të sillte Kleonymin në fronin e Spartës, por të bëhej ai vetë zot i Peloponezit", siç shkruan Plutarku. Justini shkruan se "për mbrojtjen e Spartës u mblodhën aq shumë gra, sa ai u detyrua të tërhiqej, jo pse u mund, por prej turpit". Më tej ai njofton se në këtë ndeshje Pirro humbi edhe të birin, Ptolemeun: "Në kohën e sulmit kundër spartanëve ai u fut me kalin e tij në mes të qytetit dhe u vra nga turma që u grumbullua atje. Kur trupin e tij ja prunë të atit, thonë se Pirro u tha: Ptolemeu vdiq më vonë nga ç'kishte frikë ai dhe më vonë se sa pritej, po të gjykojmë nga trimëria e tij e papërbajtur".

Pirro e ktheu ushtrinë e tij kundër Antigon Dosonit, e theu atë pranë qytetit Argos dhe hyri për të pushtuar qytetin. Atje e priste vdekja. Plini shkruante se perënditë e kishin paralajmëruar: "Pirro kur flijoi ditën që u vra, krerët e bagëtive të therura, u tërhoqën zvarrë dhe lëpinë gjakun e tyre". Plutarku jep një variant tjeter. Në sheshin e qytetit Pirro pa një përmendore prej bronzi që paraqiste një ujk që ndeshej me një derr

të egër. U kujtua, atëherë se orakulli i kishte thënë se do vdiste në vendin ku do të shikonte një skenë të tillë dhe urdhëroi têrheqjen nga qyteti. Por ishte vonë, sepse e gjithë ushtria e tij ishte futur në qytet dhe elefantët kishin shkaktuar një rrëmujë. Jas i përshkruan Plutarku çastet e fundit të jetës së mbretit të famshëm epirot:

"Pirrua, duke e parë rrezikun dhe rrëmujën që e rrethonte, hoqi diademën që shquante përkrenaren e tij nga të tjerët dhe ia dha njërit prej shoqëruesve; pastaj, me besim te forca e kalit të tij, u vërsul kundër armiqve që po e ndiqnin. I goditur nga një heshtë që i shpoi këmishën e hekurt, por që nuk i shkaktoi ndonjë plagë vdekjeprurëse e as të rëndë, u vërsul kundër atij që e plagosi, i cili ishte një banor i qytetit Argos, jo nga ndonjë familje e shquar, por bir i një plake të varfër. Kjo, sikurse edhe gratë e tjera, po shikonte në atë kohë betejën nga çatia e shtëpisë; kur pa të birin në përlleshje me Pirron, e tronditur nga rreziku që i kërcënohej, rrëmbeu me të dy duart një tjegull dhe ja lëshoi armikut. E goditi në kokë, nën përkrenare, duke i thyer boshtin e qafës; iu errën sytë, frenat i shpëtuan nga dora dhe i têrhequr nga kali i tij deri te muri i Licinit... u rrëzua, i panjohur prej shumëkujt. Por Zopyri, që shërbente nën Antigonin dhe dy, apo tre të tjerë, e panë menjëherë dhe pasi e njohën, e tërhoqën në një oborr, ku ai filloi të përmendej nga goditja që kishte

marrë. Atëherë kur Zopyri kishte nxjerrë shpatën ilire pér t'i prerë kokën, Pirro i hodhi një shikim kërcënues. Ai u tmerrua dhe iu drodhën duart. Megjithatë, nga që donte ta kryente këtë akt, e goditi...”.

Pausania na ka dhënë një variant të ngjashëm të atij fundi tragjik: “Në mes të zjarrit të betejës Pirro u nda nga shokët dhe mori një rrugicë pér të ndjekur armiqjtë. Mirëpo, kur po shkonte kaluar, thonë se një grua i ra Pirros me një tjegull në kokë dhe e rrëzoi të vdekur nga kali. Banorët e Argos thonë se nuk e vau një grua, por perëndesha Demetra e shndërruar në grua... Në vendin ku ra Pirro ndodhet një faltore e Demetrës që e ndërtuan qytetarët pas një orakulli hyjnor; po aty u varros edhe Pirro. Unë çuditem se si të gjithë aiakidët kanë vdekur në të njëjtën mënyrë sipas një vendimi hyjnor. Homeri shkruan se Akili u vra nga Aleksandri, i biri i Priamit, dhe nga Apolloni”. Ndërsa Justini ka lënë një variant më të ndryshëm: “Pirro...ra i goditur nga një gur që ia hodhën nga muri, kur po luftonte aty ku përlleshja ishte ndezur më shumë... Kokën e tij ja prunë Antigonit, i cili e shfrytëzoi fitoren në mënyrë shumë të matur: të birin e Pirros, Helenin, që iu dorëzua bashkë me epirotët, ai e lejoi të kthehet në mbretërinë e tij dhe i dha me vete eshtrat e të atit që t'i conte në atdhe”. Ka edhe një variant më pak heroik të treguar nga Zonara: “...në vitin e pestë si la Italinë, sulmoi Heladën; jo shumë më

vonë vdiq në Argos. Siç thuhet, një grua, duke dashur ta shikonte nga çatia, kur ai ishte duke kaluar, gaboi dhe duke rënë e vau atë”.

Pas kësaj vdekjeje tragjike pushteti në Epir kaloi në duart e Aleksandrit II, djalit të Pirros nga Lanasa, që ishte martuar me motrën e tij me nënë tjetër, Olimpinë. Ai bëri menjëherë paqe me Maqedoninë e mbretit Antigon Gonata, duke ruajtur kufijtë e mbretërisë epirote. Ai tërhoqi edhe trupat epirote nga Tarenti dhe bëri paqe me romakët, duke ia dorëzuar atyre qytetin. Në vitin 270 p.Kr. Aleksandri II përpinqet të ruajë kufijtë veriorë të mbretërisë dhe thyen ushtrinë e mbretit ilir Mytil, që ishte lidhur me armiqjtë e Aleksandrit II, etolët. Pas disa vjetësh më 263 p.Kr., ai iu kthye Maqedonisë, duke thyer rëndë ushtrinë e mbretit Antigon Gonata dhe duke pushtuar krahinat kufitare. Kundërofensiva maqedone ishte e menjëhershme nën drejtimin e djalit të Antigonit, Demetrit. Ushtria e tij u fut në Epir dhe Aleksandri II u detyrua të arratisëj në Akarnani. Një vit më vonë Aleksandri u kthye përsëri në Epir me ndihmën e etolëve dhe akarnanëve. Ai vdiq rrëth vitit 250, duke lënë në fron të shoqen, Olimpinë, si regjente të djalit të vogël, Pirros II.

Olimpia zgjodhi një rrugë tjetër pér mbrojtjen e kufijve të mbretërisë epirote, atë të aleancave, duke martuar të bijën,

Fthia, me mbretin e Maqedonisë, Demetrin. Kështu u sigurua një paqe e përkohshme, por mbretit Pirro II iu desh të ndeshej me etolët që u dyndën në Epir. Ai nuk sundoi gjatë dhe i vëllai, që e zëvendësoi në fron, u vra në një betejë kundër etolëve. Justini na njofton se pas kësaj vdiq edhe Olimpia nga dëshpërimi i thellë. Froni i mbretërisë epirote i kaloi Deidamesë, vajzës së Aleksandrit II, që u përballua me pakënaqësinë dhe revoltën e qytetarëve të kryeqytetit, Ambrakisë. Ajo u strehua në tempullin e Artemisit, por u vra atje nga kryengritësit, të cilët shkatërruan varret e mbretërve të fundit epirotë, ndërsa hiri i mbretit Pirro u shpërnda rrugëve të qytetit. Monarkia u rrëzua dhe u shpall republika me emrin Lidhja Epirote, me kryeqytet Foiniken.

### Figurë e shquar e antikitetit

Justini i ka bërë një nga vlerësimet më të denja mbretit epirot: "Të gjithë shkrimtarët janë thuajse të një mendimi se asnje mbret, qoftë nga bashkëkohësit e Pirros, qoftë nga ata që kanë jetuar më përpara, nuk mund të krahasohen me të; rrallë mund të shihej, jo vetëm midis mbretërve, por edhe midis burrave të shquar, një njeri kaq pa të meta dhe kaq i drejtë. Aq mirë e njihte ai artin ushtarak, saqë duke luftuar me Lisimahun, Demetrin, Antigonin, me këta mbretër të mëdhenj, ai dilte gjithmonë fitues...Atdheun e tij, një vend të vobektë e të padëgjuar, ai e

bëri me të vërtetë të përmendur në të gjithë botën me lavdinë e heroizmave të tij dhe me shkëlqimin e emrit të tij". Dhe me të vërtetë Tit Livi kishte shkruar: "Hanibali thotë se ndër komandantët më të mëdhenj (pas Aleksandrit), i dyti vinte Pirro, sepse ky ishte i pari që i mësoi të tjerët si të vendosnin lëmin. Përveç kësaj asnje nuk ka ditur më mirë se ai të njohë dhe të zgjedhë vendin për vendosjen e rojave dhe dinte t'i këshillonte njerëzit aq mirë, sa që popujt e Italisë deshën më mirë t'i sundonte një mbret i huaj, se sa populli romak, që ishte prej kohësh në krye të kësaj toke".

Këtë mendim kishte edhe Lukiani, kur shkruante se: "...meriton të përmendet edhe Pirro Epiroti, burrë i cili pas Aleksandrit, në çështje ushtarake zinte vendin e dytë...Ky i lutej perëndive, u bënte fli dhe dhurata, por kurrë nuk kërkoi prej tyre fitore e dinjitet më të madh mbretëror, lavdi dhe pasuri të tepruar; lutej vetëm për një gjë, të ishte shëndoshë, se po të kishte këtë, të tjerat do t'i kishte vetë me lehtësi".

Arti ushtarak i Pirros do të përvetësohej nga strategët e antikitetit, edhe shumë shekuj pas vdekjes së tij, siç vihej në dukje nga shkrimtari romak, Amian Marcelini, që shkruante se perandori Julian (361-363 m.Kr.) imitoi Pirron, "...mbret i epirotëve, një nga gjeneralët më të ditur për sa i përket artit për të përfituar nga terreni, për të shtrirë dhe për të mbledhur radhët

në betejë dhe për të shtuar apo pakësuar forcat ushtarake para syve të armikut, sipas nevojës”.

Nga Pirro nuk kemi asnje paraqitje të sigurt të portretit por vetëm emrin e tij në një monedhë të Sirakuzës (fig.7). Pausania

na njofton se ka pasur një shtatore të tij në Altis të Olimpias, kushtuar nga Thrasibuli, nga Eleioni. Është po ky autor që shkruante se: “Në Athinë gjendet portreti i Pirros. Ky nuk i ngjante fare Aleksandrit, me të cilin ishte fis”.



Fig. 7. Monedhë e Sirakuzës me emrin e mbretit Pirro. Rreth vitit 280 p. Kr.

# Lugina e Drinosit në Antikitet

## Popullsia dhe Ngjarjet

### Rrugët antike

Lugina e Drinosit ka qenë nga trevat më të zhvilluara në periudhën antike (fig.8). Tre qytete të rëndësishme dhe pesë kështjella vigjiloin mbi një fushë të favorshme për zhvillimin e bujqësisë, por edhe mbi shtigjet që çonin drejt kullotave të pasura. Por rëndësinë më të madhe ia jepte atyre kontrolli mbi rrugën e rëndësishme natyrore që përshkonte luginën, duke lidhur fushën bregdetare ilire me Kaoninë dhe Molosinë.

Reshtimi i qyteteve dhe kështjellave na jep edhe drejtimin e rrugëve antike. Udhëtarë që nisej asokohe nga Apollonia, Dimali, Bylisi, apo Amantia, përshkonte luginën e Aosit (Vjosës) deri në bashkimin e saj me lumin Drinos. Aty ku fillonin grykat e Antigonesë, ai i ngjitej bregut të majtë të Drinosit, për të arritur në kështjellen e Leklit, e cila mbronte kalimin nëpër ngushticën e Antigonesë. Aty rruga e lashtë degëzohej në drejtim të Molosisë, ose të Kaonisë. Ai që zgjidhte drejtimin e parë duhej të vazhdonte përgjatë fundit të shpateve të maleve, ku gjenden sot fshatrat e krahanës së Lunxhërisë (fig.9), për të arritur në qytetin e Antigonesë, pranë fshatit të sotëm Saraqinisht. Në vazhdim të




Fig. 8. Harta e luginës së Drinosit me qendrat antike.

rrugës, udhëtarë duhet të zbriste në vaun e lumit Suhë, për t'u ngjitur përsëri drejt një qyteti tjeter, që gjendej në kodrën e Melanit, pranë fshatit Nepravishtë. Atij do t'i duhej



Fig. 9. Grykat e Antigonesë dhe krahina e Lunxhërisë.

edhe po aq rrugë, për të arritur në qytetin e tretë të luginës, që ndodhej jo shumë larg Kakavisë, pranë fshatit grek Ktismata. Përtej qafës fillonte Molosia dhe rruga të konte drejt Pasaronit, në bregun e liqenit të Janinës, apo drejt Dodonës.

Drejtimi tjetër, për në Kaoni, ndiqte luginën e lumbit të Kardhiqit, që kontrollohej nga një kështjellë në kodrën e fshatit me të njëjtin emër. Pasi kalonte qafën e Skërficës, udhëtari gjendej vetëm disa orë larg kryeqytetit të Kaonisë, Foinikes, pranë fshatit Finiq të Sarandës.

### Emri antik dhe popullsia

Me një pozitë të tillë strategjike lugina nuk mund t'i shpëtonte ngjarjeve të rëndësishme gjatë antikititetit. Autorët e lashtë e quanin

atë Atintania, krahina më jugore e Ilirisë. Historiani i lashtë helen, Tukididi (II, 80, 6), na njofton se në vitin 429 p.Kr. atintanët bënин pjesë në Mbretërinë Molose dhe prijësi i tyre ishte Sabylinthi, kujdestar i mbretit Tharypas, ende fëmijë. Nën drejtimin e tij molosët dhe atintanët morën pjesë në një sulm kundër krahinës kufitare greke, por u thyen dhe u tërroqën pa humbje të mëdha në vendin e tyre.

Atintanët do të shfaqen përsëri në dritën e historisë rreth 50 vjet më vonë. Gjeografi helen Skylaksi (Illyr.,26) i përmend ata midis popullsive ilire dhe si banorë të një krahine të gjerë që shtrihet në viset e brendshme, "...sipër Orikisë dhe Kaonisë, deri në Dodonë". Kjo shtrirje përkon me luginën e mesme të Aosit dhe tërë luginën

e Drinosit, ku atintanët kishin formuar një koinon, një republikë tashmë e pavarur nga Mbretëria Molose. Skylaksi shkruan edhe për krahanën e Kastidës, ku gjendej fusha e quajtur Erytheia, por ne nuk mund të jemi të sigurt se bëhet fjalë për luginën e Drinosit dhe fushën e Dropullit. Asnjë autor tjetër i lashtësisë nuk i përmend më këto toponime. Rreth 50 vjet më vonë është Aristoteli (De mir. ausc., 833 a 36), që shkruan për Atintaninë si vendi ku gjendej “një shkëmb, nga i cili nuk duket se del zjarr i vërtetë, por ndizet duke i hedhur vaj”. Sigurisht që bëhet fjalë për Nymfeun, që ndodhej në pjesën më perëndimore të Atintanisë, fqinjë me Apolloninë.

### Atintanët dhe antigoneasit

Në këtë hapësirë koinoni i atintanëve luajti një rol të rëndësishëm në ngjarjet që u zhvilluan në prag dhe gjatë luftës I ilire-romake. Historiani i lashtë helen, Polibi na ka lënë një përshkrim të fushatës që organizoi mbretëresha e Ilirisë, Teuta, për pushtimin e kryeqytetit të Lidhjes së Epirit, Foinikes, në vitin 230 p.Kr. Flota ilire kishte zbarkuar në befasi disa mijëra luftëtarë në gjirin e Sarandës, të cilët kishin pushtuar me sulmin e parë Foiniken, duke shfrytëzuar tradhtinë e garnizonit të qytetit, të përbërë nga mercenarë galë. Një ushtri tjetër ilire prej 5000 luftëtarësh ishte ngjitur nëpër luginën e Aosit, nën drejtimin e kunatit të Teutës, Skerdilaidit, duke kaluar nëpër

ngushticat e Antigonesë. Ndërkohë një ushtri epirote kishte vrapuar në ndihmë të Foinikes dhe kishte ngritur lëmin përkarshi saj, në fushën e Helikranonit, përtej lumit Bistricë. Forca të tjera ishin nisur për të përforcuar mbrojtjen e qytetit të Antigonesë, që rrezikohej të pushtohej, gjithashtu, nga ushtria ilire. Por synimi i Skerdilaidit ishte Foinike, sepse ai u shfaq para saj befasisht, duke kaluar nga rruga më e shkurtër, nëpër luginën e Kardhiqit dhe qafën e Skërficës. Në betejën që u zhvillua në Helikranon ushtria epirote pësoi një disfatë të rëndë. Polibi (II, 5, 8) na njofton se “...epirotët u mundën, shumë mbetën të vrarë dhe më shumë u zunë robër; të tjerët ikën dhe shkuan tek atintanët”. Nuk ka dyshim se këta atintanë ishin banorët e luginës së Drinosit, rreth Antigonesë, që kishte mbetur e papushtuar nga Skerdilaidi dhe ku gjendej një pjesë e forcave epirote të dërguara më parë. Nuk ka dyshim, gjithashtu, se ata përfaqësonin një njësi të pavarur politike, sepse nuk u përfshinë në konflikt dhe as në paqen që u nënshkrua më pas ndërmjet Mbretërisë Ilire dhe Lidhjes Epirote. Si të tillë ata dalin edhe një vit më pas.

Në vitin 229 plasi lufta ilire-romake. Flota e Teutës nën drejtimin e Demetër Farit pushtoi Korkyrën dhe bllokoi nga deti Apolloninë dhe Dyrrahun. Senati Romak dërgoi menjëherë kundër ilirëve një flotë prej 200 anijesh nën drejtimin e konsullit Gnej Fulvi, e cili mori në zotërim Korkyrën

(Korfuzin), pas tradhtisë së komandantit ilir. Pastaj lundroi në drejtim të Apollonisë, ku u takua me këmbësorinë romake, që kishte zbarkuar aty nga Brindisi nën drejtimin e konsullit tjetër, Aul Postumit. Pasi morën Dyrrahun dhe nënshtuan arđianët, Polibi (II, 11, 11) shkruan se "...u bashkuani me ta edhe parthinët dhe atintanët, që dërguan delegatë për t'iu nënshtuar me dashje...". Sigurisht që këtu bëhet fjalë për prapatokën e Apollonisë, ku shtrihej koinoni i atintanëve, përgjatë luginës së mesme të Aosit dhe luginës së Drinosit, si dhe për prapatokën e Dyrrahut, ku shtrihej koinoni i parthineve.

Që nga këto ngjarje Atintania mori një rëndësi strategjike për Senatin Romak, si një zonë nga mund të kontrolloheshin rrugët që të çonin nga Apollonia në Epir dhe Maqedoni, por edhe mund të izoloheshin të dy shtetet nga një aleancë e mundshme kundër Romës. Këtë e kuptoi edhe mbreti i Maqedonisë, Filipi V, i cili më 215 p.Kr. lidhi një marrëveshje me gjeneralin kartagas, Hanibalin, kundër Romës. Një nga kushtet e saj ishte që pas fitores Atintania t'i jepej Maqedonisë (Polyb. VII, 9, 13). Duke përfituar nga vështirësitë e Romës në luftë kundër Kartagjenës, Filipi e pushtoi Atintaninë në vitin 211 dhe e përdori si bazë për të sulmuar Apolloninë. Nga historiani romak Tit Livi (XXVII, 30, 13; XXIX, 12, 13) mësojmë se ai e zotëronte atë krahinë edhe në vitin 208 dhe se romakët u detyruan ta njojin atë pushtim

edhe në paqen që bënë me Filipin në qytetin e Foinikes më 205 p.Kr.

Pas fitores mbi Kartagjenën Senati Romak i ktheu sytë përsëri nga Iliria. Në vitin 200 p.Kr. një ushtri nën komandën e konsullit Sulpici, që ishte vendosur midis Dyrrahut dhe Apollonisë, nisi luftën kundër Filipit V të Maqedonisë. Kjo ishte koha kur atintanët dhe qendra e tyre, Antigoneia, u shkëputën nga Maqedonia dhe u lidhën me kaonët, aleatë të Romës. Dy vjet më vonë, në vitin 198 p.Kr., Filipi V vendosi të bënte një fushatë ushtarake kundër Maqedonisë dhe u shfaq me ushtrinë e tij në ngushticat e Aosit, pranë fshatit Dragot të Tepelenës. Vetë mbreti vendosi kampin kryesor rrëzë malit Asnau, Goliku i sotëm, ndërsa gjenerali i tij, Athenagoras, u vendos në bregun tjetër të lumit, rrëzë malit Merop, Trebeshina e sotme. Në këtë mënyrë Filipi vuri nën kontroll kryqëzimin e rrugëve natyrore që lidhnin Kaoninë, Ilirinë e Jugut dhe Maqedoninë. Por edhe Roma nuk qëndronte duarkryq. Një ushtri romake, nën drejtimin e konsullit Tit Flamini, zbarkoi nga Korkyra në Kaoni dhe përmes Atintanisë u shfaq para ngushticave të Aosit. Udhëheqësi i kaonëve, Haropi, i dërgoi atij një bari vendës, i cili udhëhoqi një repart romak përmes maleve, për ta nxjerrë prapa shpinës së maqedonasve. Të vënë midis dy zjarresh maqedonasit u thyen dhe Filipi V u tërroq me ngut përpjetë luginës së Aosit për në Maqedoni.

Pas kësaj ngjarjet u zhvendosën në thellësi të vendit, në kufijtë e Maqedonisë, apo në Greqi. Atintania dhe Antigoneia nuk përmenden për tri dekadat në vazhdim, gjë që do të thotë se ato jetuan në paqe.

## Fundi i Antigonesë

Në vitin 169, mbreti i Ilirisë, Genti, dhe ai i Maqedonisë, Perseu, filluan veprimet ushtarake kundër romakëve. Epirotët u ndanë më dysh: kaonët dhe thesprotët morën anën e Romës, ndërsa molosët, atë të maqedonasve. Tit Livi (XLIII, 21, 4 dhe 23, 1-6) na njofton për disa ngjarje që u zhvilluan atë vit rreth Antigonesë. Thesprotët dhe kaonët kishin rrëthuar qytetin epirot Fanote, të pushtuar nga komandanti maqedonas Klevas. Në ndihmë të tyre kishte ardhur edhe komandanti romak Ap Klaudi, duke kaluar nga Apollonia nëpër luginën e Aosit dhe tokat e atintanëve. Një lëvizje e ushtrisë maqedonase, nën drejtimin e mbretit Perse, në kufijtë jugorë të Epirit, e trembi Ap Klaudin, i cili u tërroq me trupat e tij dhe, pasi kaloi ngushticat, ngriti kampin në fushën e quajtur Meleona. Klevasi e ndoqi nga prapa me trupat maqedonas, të përforcuara edhe me luftëtarët molosë dhe zbriti në fushën e Antigonesë. Ai përdori një dredhi luftarake për t'i zënë në kurth antigoneasit. Lëshoi ushtarët maqedonas për të plaçkitur rrëthinat e qytetit, ndërsa molosët i fshehu në një pritë. "Burrat e armatosur të Antigonesë - tregon Tit Livi - u

sulën mbi plaçkitësit e shpërndarë, por të rrëmbyer nga ndjekja që i bën atyre që i knin, shkuan e ranë në grackën e përgatitur nga armiqjtë. Pasi aty u vranë gjashtëqind vetë dhe u zunë rreth njëqind... marshuan drejt lëmit të Apit, me qëllim që nga ana e ushtrisë romake të mos shpërthente ndonjë sulm mbi aleatët e tyre". Ap Klaudi e mënjanoi betejën dhe u tërroq me trupat e tij për në Apolloni, pasi kishte dërguar për në vendet e tyre luftëtarët kaonë dhe thesprotë. Nga ky përshkrim kuptohet se disfata e antigoneasve ndodhi në fushën e Dropullit. Qyteti Fanote ndodhej sigurisht në anën jugore të luginës, ku ajo lidhej me Molosinë, dhe korrespondon ose me rrënojat e Ktismatës, përtej qafës së Kakavisë, ose me qytetin antik të Malçanit, në krahinën e Theollogos. Kampi i Ap Klaudit gjendej përtej grykave të Antigonesë, në fushat ndërmjet Tepelenës e Memaliajt.

Tit Livi nuk na thotë se çfarë bënë maqedonasit fitimtarë, pasi u larguan romakët. Një mundësi është që ata ta kenë sulmuar dhe djegur Antigonën. Kjo do të përputhej me gjurmët e zjarreve që janë gjetur gjatë gërmimeve arkeologjike në shumë banesa të qytetit, si dhe me faktin se që nga kjo kohë Antigoneia braktiset si qytet.

Mundësia tjeterë është që Antigoneia të jetë shkatërruar në ngjarjet që pasuan. Më 168 p.Kr. ushtria romake nën drejtimin e L. Anicit, pasi kishte shkatërruar mbretërinë e Gentit, u nis drejt Epirit, duke kaluar

nëpër luginën e Aosit. Tit Livi (XLV, 26, 3-15) tregon se ai pushtoi Fanoten dhe pastaj u fut në Molosi, duke pushtuar kryeqytetin e lashtë të saj, Pasaronin, pranë lisenit të Janinës. Ai nuk ndeshi asnë qëndresë dhe qytete të tjera pranuan nënshtrimin ndaj Romës. Si rrjedhim nuk është e mundshme që Antigoneia të jetë shkatërruar gjatë kësaj fushatë të ushtrisë romake.

Mundësia e tretë është që Antigoneia të jetë përfshirë në listën e shtatëdhjetë qyteteve epirote që u shkatërruan nga konsulli Emil Pauli në vitin 167 p.Kr. Tit Livi shkruan se senati kishte urdhëruar që të ndëshkoheshin me plaçkitje e shkatërrim ato qytete që kishin përkrahur në luftë mbretin maqedonas, Perseun, por duket se qëllimi ishte shpërblimi i ushtarëve romakë për tre vjetët e kaluar në Iliri dhe Epir. Vetë Emil Pauli urdhëroi edhe plaçkitjen e shkatërrimin e qyteteve ilire në rrugën nga Pasaroni në Orik. Gërmimet arkeologjike dëshmojnë se në këtë fushatë u shkatërruan qytetet ilire në Margëlliç pranë Patosit, Gurëzëzë pranë Cakranit, Klos pranë Ballshit, etj. Si rrjedhim, nuk mund të përjashtohet mundësia që edhe Antigoneia të ketë pësuar të njëjtin fat.

Sidoqoftë, kjo është hera e fundit që ngjarjet historike thuren rreth Antigonesë. Historianët heshtin përgjithmonë dhe kujtimi i qytetit të ndërtuar nga Pirro mbetet në shënimet dhe hartat gjeografike. Në shek.I m.Kr. Plini (NH, IV, 10) e përmend

Antigonënë si një nga qytetet e provincës së Maqedonisë, por rreshtimi është kaq larg në lindje (“...kolonia Pela, fortesa Stobi me të drejtën romake, pastaj Antigoneia, Europi mbi lumin Aks...”), sa mund të mendohet edhe për një tjetër qytet, që mbante emrin e mbretit maqedonas, Antigonit.

Një shekull më pas Antigoneia gjendet në hartën e gjeografit aleksandrin, Ptolemeut, i cili e vendos në viset e brendshme të Epirit, krahas qyteteve të panjohura me emrat Hekatonpedon, Omfalion dhe Helaon. Nga gërmimet arkeologjike ne dimë se Antigoneia e kësaj kohe ishte një grumbull rrënojash të mbuluara prej kohësh nga bari, ndërsa qendra e krahinës gjendej në qytetin Hadrianopol, të ndërtuar në kohën e sundimit të perandorit Hadrian (117-138 m. Kr.). Po kaq larg kohës ishte edhe fjalori i Stefan Bizantinit, i formuluar në shek.VI m.Kr., që e përmend Antigonënë si “qytet i Kaonisë në Epir”, ndërsa Atintaninë si “krahinë e Maqedonisë”. Duket se të dhënat e tij vinin nga autorë dhe kohë të ndryshme. Antigoneia mund të ketë qenë pjesë e Kaonisë pas krijimit të Lidhjes Epirote (232-167 p.Kr.), ndërsa Atintania u bë pjesë e provincës së Maqedonisë pas formimit të saj në vitin 167 p.Kr.

Ky është në përgjithësi trashëgimi historik i autorëve të lashtë mbi Antigonënë dhe krahinën e Atintanëve, i cili plotësohet dhe pasurohet më shumë nga të dhënat e gërmimeve arkeologjike.

# *Qyteti Antik i Antigonesë*


## Pamja e qytetit antik

**Agoraja.** Qyteti antik i Antigonesë shtrihet mbi kodrën e Jermës, në jugperëndim të fshatit Saraqinisht të krahinës së Lunxhërisë (fig.10). Një pllajë në formë katërkëndëshe, që pjerrëzohet nga veriu në jug kurorëzonte lartësitë e kësaj kodre, duke ofruar rrafshë të përshtatshme për banim. Ajo zotërohej nga maja e Shën Mëhillit, e cila ka përbërë edhe akropolin e Antigonesë.

Rreth vitis 295 p.Kr. kjo pllajë u zgjodh nga arkitektët e Pirros për të ndërtuar qytetin që do të përjetësonë emrin e gruas së tij, Antigonës. Përzgjedhja bazohej në pozitën zotëruese që kishte kodra mbi gjithë luginën e lumit Drinos, por edhe mbi kontrollin e drejtpërdrejt të rrugës natyrore, që e përshkonte atë luginë përgjatë shpatit perëndimor të malit. Ndërtimi i qytetit u bë sipas një planit të vetëm, që përfaqëson te tipin e qendrave të sundimtarëve të periudhës pas



Fig. 10. Pamje e kodrës së Jermës, ku gjendet qyteti antik i Antigonesë.



11. Planimetria e qytetit antik të Antigonës.

Aleksandrit të Madh, të njohur në shembujt e Prianës, Pergamit, etj. Një mur rrrethues me gjatësi 3700 m rrrethoi pllajën e kodrës, duke përshkuar afërsisht të njëtin izohips (fig.11). Brenda saj u përfshinë katër zona me funksione të ndryshme. Në pjesën më të lartë, nën kodrën e Shën Mëhillit, u veçua me një mur transversal *basileia*, që ishte vendi i banesës së Pirros dhe Antigonës, kur mund të vinin në qytet.

Në pjesën qendrore të pllajës, ku kishte edhe një burim uji, u vendos agoraja, që ishte zona e ndërtimeve shoqërore dhe e sheshit publik. Rrafshet jugore të pllajës, pranë hyrjes kryesore të qytetit, u rezervuan për euhorionin. Kjo ishte zona ku në rast lufte strehoheshin banorët e rrrethinave të qytetit, së bashku me bagëtitë

dhe pasurinë që mund të merrej me vete.

Sipërfaqja që mbetej dhe që ishte më e madhja, u caktua për vendosjen e banesave, sipas një sistemi që njihet si hipodamik. Një sistem rrugësh që priteshin në kënd të drejtë e ndanin sipërfaqen që do të banohej në insula (ishuj), me një numër afërsisht të barabartë banesash.

Cdo insul kishte gjatësi 106 m dhe gjerësi 53 m, në një raport 1:2. Ato përshkoheshin për së gjati nga një rrugicë me gjerësi 2 m që shërbente për të ndarë shtëpitë nga njëratjetra dhe për të kulluar ujërat e shirave. Rrugët kryesore formonin akset veri-jug dhe kanë gjerësi 7 m. Në anë të tyre janë krijuar trotuare me gjerësi 1,5 m.

Dy rrugë kryesore kryqëzoheshin në hyrje të agorasë (fig.12), e cila shtrihej në një sipërfaqe të barabartë me gjashtë insula (rreth 3 ha). Aty ishin vendosur monumentet publike të qytetit, nga të cilat janë zbuluar vetëm dy prej tyre: prytaneioni dhe stoa (shëtitorja). Duhet pritur që në anën perëndimore të zbulohet edhe hyrja e veçantë e agorasë, e cila e lidhë atë me rrrethinat e qytetit, ashtu siç e ndeshim në një radhë qytetesh ilire dhe epirote.



Sistemi urbanistik i Antigonesë përfaqëson fazën më të zhvilluar të një tipi të organizimit të hapësirës qytetare, të zhvilluar në Iliri (Apolloni, Bylis, Antigone) dhe në Epir (Kasope) gjatë shek.III-II p.Kr. dhe që karakterizohet nga insulat e përzgjatura në raport 1:2 dhe nga vendosja periferike e agorasë.

**Stoa** gjendet në pjesën më të lartë të agorasë dhe kufizon nga jugu rrugën kryesore që e përshkon atë (fig.13 A,B). Ndërtesa ka gjatësi 59 m dhe gjerësi 9.50 m, përmasa të mbështetura në modulin e këmbës epirote, afersisht 30 cm. Disa bazamente të ruajtura dëshmojnë se ndërtesa ndahej për së gjati nga një kolonadë, duke krijuar dy rrugina për shëtitje. Një zgjerim i ndërtesës në krahun



Fig. 12. Kryqëzim rrugësh dhe planimetria e insulave.

perëndimor ka shërbyer për vendosjen e kafazit të shkallëve që të çonin në katin e dytë. E gjithë fasada jugore e monumentit ishte e hapur, duke i dhënë mundësi publikut që të shikonte përmes kolonadave drejt sheshit kryesor të agorasë. Monumente të ngjashme nga forma dhe përmasat, që shërbën si



13. Stoa e Antigonesë. Pamja dhe planimetria.



Fig. 14. Pjesë të grupit skulpturor prej bronzi të gjetura pranë stoas.

shëtitore publike, janë gjetur në Kasope të Thesprotisë dhe në Bylis.

Gjatë gërmimit të stoas, pranë murit

jugor të saj u gjet një pitos, i cili përbante pjesë të një grupei skulpturor prej bronzi (fig.14). Bien në sy bishti i një kali dhe një


## Qyteti Antik i Antigonesë

për krenare e veçantë pér kuaj, që dëshmojnë pér një shtatore kalorësi. Nga vetë kalorësi ruhet vetëm një copë e shpatës së tipit *mahaира*. Ndërkohë, një dorë delikate femre me një unazë në gisht dëshmon edhe pér një shtatore femre, që plotësonte grupin. Mund tē mendohet se ky grup paraqiste Pirron mbi kalë dhe gruan e tij, Antigonën, pranë tij.

Lind pyetja se pérse këto pjesë ishin groposur pranë stoas, në një kënd të sheshit? Mundësia e parë është që grupi skulpturor tē ishte shkatërruar pas pushtimit dhe rrënimt tē qytetit nga romakët. Pjesë tē

tij mund tē ishin fshehur nga dikush pér t'u shkrirë dhe ripërdorur në punimin e sendeve prej bronzi. Një mundësi e dytë është që këto pjesë tē kenë mbetur si skarco gjatë përgatitjes së skulpturave në vend dhe tē jenë groposur pér arsyen tē panjohura. Sidoqoftë, gjetja e tyre është një dëshmi e pasurisë së qytetit dhe e veprimtarisë artistike që zhvillohej atje.

**Prytaneioni.** Ai gjendet në kryqëzimin e rrugëve kryesore që veçojnë agoranë nga zona e banuar (fig.15 A, B). Ka planimetri



15. Pamja dhe planimetria e prytaneionit.

katërkëndëshe me përmasa  $18 \times 8.20$  m. Fasada e monumentit zbulurohej me një kolonadë prej katër shtyllash dorike të punuara me gurin gëlqeror konglomerat të vendit. Pas hajatit të ngushtë, dy shtylla të tjera të njëllojta përcaktojnë kalimin drejt një korridori, prej të cilit komunikohej me dy kthinat e monumentit. Kjo vendosje e ambienteve është e njobur në monumentet e zbuluara në Bylis dhe në Kasope, të shpjeguara si prytaneione. Këto ishin ndërtesa publike që shërbën si zyra të prytanëve, pra të drejtuesve civilë të qytetit, të zgjedhur çdo vit me votim të përgjithshëm. Në të vërtetë, në Antigone nëpunësi më i lartë i qytetit kishte funksionin e strategut (gjeneralit), që ishte një traditë e qyteteve

të Epirit. Kjo vërtetohet nga gjetja e një mbishkrimi mbi një vulë në njérën nga banesat e qytetit.

### Banesat e qytetit


Gërmimet arkeologjike të zhvilluara nga Dhimosten Budina në Antigone gjatë viteve 1966-1990 kanë qenë përqendruar kryesisht në zbulimin e banesave të qytetit të lashtë. Ato u shpërndanë në tre sektorë të veçantë, duke synuar të siguronin të dhëna mbi gjendjen shoqërore-ekonomike të lagjeve të ndryshme, si dhe për sistemin urbanistik të qytetit.

### Sektori B

Në qendër të qytetit antik, në insulat kufizuese me agoranë, u vendos **sektori B** i



Fig. 16. Banesa me peristil. Pamja dhe planimetria.



gërmimeve, duke pasur si objekt një banesë të vendosur në anën jugore të rrugës kryesore, që i takonte, padyshim, shtresave të pasura. Pas zbulimit të plotë mund të bëhej edhe rindërtimi ideal i tyre, për të kuptuar nivelin e jetesës së qytetarëve të shquar të Antigonesë.

**Banesa me peristil** kishte planimetri katërkëndëshe  $30 \times 22$  m, me një sipërfaqe të përgjithshme prej  $660$  m $^2$ . Qendrën e formulimit arkitektonik të saje përfaqëson një oborr i brendshëm katërkëndësh  $9.80 \times 10.80$  m, që rrethohej nga një kolonadë (*peristil*) prej 12 shtyllash të ordrit jonik me lartësi  $3.70$  m (fig.16 A, B). Rreth tij kishte një hajat me gjerësi  $3.5$  m, ku zhvillohej një pjesë e jetës së familjes gjatë muajve të ngrohtë. Ky hajat komunikonte drejtpërdrejt me rrugën përmes një korridori me gjatësi  $3.8$  m, që hapej pas portës dykanatëshe.

Në anën lindore të oborrit gjendeshin tri dhomat kryesore të banesës. Ajo e mesit, që shërbente për pritjen e miqve (*andron*), lidhej me hajatin përmes një kolonade prej katër shtyllash jonike. Një radhë kthinash të tjera ishin rreshtuar në krahun e murit kufizues me rrugën. Ato kishin funksione shërbimi. Shtëpia kishte edhe një kat të dytë që ngrihej mbi dhomat e anës lindore dhe veriore (fig.17). Ajo ka qenë ndërtuar me bloqe gurësh katërkëndësh, mbi të cilat ngriheshin mure qerpiçesh, dhe ka qenë e mbuluar me tjegulla.




Fig. 17. Rikonstruksion ideal i banesës me peristil.

Gjatë gërmimit të banesës u gjet një shtresë djegieje, që dëshmonte për shkatërrimin nga zjarri të kësaj banese gjatë ngjarjeve të vitit 167 p.Kr. Pas kësaj ishin bërë përpjekje për të rindërtuar një pjesë të saj, me sa duket nga banorët që i shpëtuan katastrofës.

**Banesa e artizanit**, u quajt nga Dh. Budina një hapësirë e dytë banimi që ndodhej në perëndim të **shtëpisë me peristil** (fig.18). Fillimi isht duket se ato kanë qenë pjesë të së njëjtës shtëpi, por kanë qenë ndarë për arsyen funksionale. Banesa e artizanit ka planimetri katërkëndëshe  $25 \times 15$  m. Ajo gjendet në një nivel më poshtë se shtëpia me peristil, me të cilën lidhej me anë të shkallëve. Fillimi isht ajo përbëhej nga dy kthina të vendosura në të dy anët




Fig. 18. Banesa e artizanit. Planimetria pas gjermimit.

e korridorit të hyrjes nga rruga e madhe, si dhe një oborr i madh i brendshëm që shërbente si kopsht, apo për zhvillimin e një aktiviteti ekonomik. Në një periudhë të dytë, në fillim të shek. II p.Kr., janë bërë ndarje të reja të kësaj pjese të banesës me peristil, duke e kthyer në banesë më vete. Një shtresë djegieje dëshmon për të njëjtin fat tragjik të banorëve të shtëpisë së re. Dh. Budina gjeti aty një enë të plotë bronzi (fig. 19) dhe disa vegla pune, që i lidhi me aktivitetin zejtar të atyre banorëve. Ai gjeti dhe një gur të madh katërkëndësh me një numër gropash të përmasave të ndryshme (fig. 20), që shërbën si njësi matëse për

drithin me të cilin mund të këmbëshin prodhimet zejtare. U gjetën edhe monedha bronzi e argjendi të viteve të fundit të Lidhjes Epirote, me të cilën Antigoneia kishte marrëdhënie ekonomike dhe politike.

**Banesa e Pirros** u quajt nga Dh. Budina banesa e tretë e rreshtuar në jug të rrugës kryesore, atje ku fillonte hapësira e agorasë (fig. 21). Ajo ka planimetri katërkëndëshe  $16 \times 11$  m, me hyrje nga perëndimi. Porta e saj ruan pragun prej guri gëlqeror në gjerësinë prej 2.12 m. Ruhen edhe bazat e dy shtyllave nga ana e rrugës, të cilat mbanin dikur strehën e portës, njëlloj si në shtëpitë lunxhiote. Menjëherë pas hyrjes kalohej në një sallë  $10 \times 4$  m që duket se ka shërbyer si katua për kuajt. Më tejk a një kthinë qendrore katërkëndëshe, që përfaqëson kafazin e shkallëve për në katin e dytë. Kthinat e tjera kishin kryesisht funksione shërbimi. Edhe kjo banesë përmبante gjurmët e një djegieje që e kishte shkatërruar banesën plotësisht. Dhjetë monedha bronzi të Lidhjes Epirote që u gjetën poshtë rrënojave, dëshmonin për panikun e banorëve të fundit të kësaj banese gjatë djegies së saj në vitin 167 p.Kr. Gjatë gjermimit të saj u gjet një enë e rrumbullakët guri (*luter*) me katër vegje që mbante mbishkrinin Pirro. Për këtë arsyе Dh. Budina e quajti këtë banesë “Shtëpia e Pirros”.

Një banesë e katërt u gjermua pjesërisht nga Dh. Budina në krahan verior të rrugës.

## *Qyteti Antik i Antigonesë*




Fig. 19. Enë bronzi e gjetur nën shtresën e djegies.



Fig. 20. Bllok guri me masat e drithit nga "Shtëpia e artizanit".



Fig. 21. "Banesa e Pirros".

Gjatë gërmimit të saj u zbulua një vatër zjarri, ku kishte mbeturina të punimit të metalit të bronzit. U gjet edhe një shufër e trashë bronzi, nga e cila ishin prerë disa rrotulla, për të cilat Dh. Budina mendonte se shërbenin për stampimin e monedhave. Kësaj banese i takon një kanal i mbuluar me pllaka guri, i cili i nxirrte ujërat e shiut nga oborri në rrugën e madhe.

### Sektori C

Me këtë emër Dh. Budina quajti gërmimin e dy banesave dhe të një rruge në insulën më veriperëndimore të qytetit (fig.22 A,B). Vetë rruga, me gjerësi 2 m, përfaqëson një pjesë të aksit veri-jug që ndante dy radhë

insulash. Ajo ka gjerësi 2 m dhe kufizohet nga muret e dy banesave, që nuk kishin dalje në atë rrugë, por në rrugën me drejtim L-P që kryqëzohet me të. Për mënyrën e ndërtimit të këtyre banesave, të dhënat arkeologjike dëshmojnë se ishin dykatëshe. Kati i parë i ndërtuar me mure qerpiçi mbi një cokolaturë gurësh, përbëhej nga ambiente shërbimi, apo punishte. Kati i dytë me dhomat e banimit, duket se ka qenë ndërtuar me dru.

**Banesa e strategut** shtrihet për 23 m në lindje të rrugës A. U quajt nga Dh. Budina shtëpia me atrium (oborr qendror). Në fakt ka një oborr të brendshëm në anën veriore, ku gjendej hyrja për në rrugën kryesore.




Fig. 22. Rruga dhe banesat e sektorit C gjatë gërmimit. Pamja dhe planimetria.

Një kanal i mbuluar me rrasha guri niste në anë të tij për të përcjellë ujërat përmes tij për t'i derdhur në rrugën dytësore që ndodhej në perëndim të banesës. Një kthinë katërkëndëshe në këndin verior të oborrit duket se shërbente si depo. Banesa shtrihej e gjitha në anën jugore të oborrit. Janë gjermuar vetëm katër kthina të kësaj banese, që komunikonin me njëratjetren. Një vatër zjarri dhe tre pitosa përuajtjen e prodhimeve të gjetura në kthinën veriperëndimore të banesës, dëshmojnë se ajo shërbente si kuzhinë. Në dyshemenë e thjeshtë të saj u gjetën 12 copë monedha bronzi të Lidhjes Epirote si dhe një figurinë e bukur bronzi e perëndisë Poseidon. Po ashtu, gjatë gjermimit të oborrit, u gjetën disa monedha të Lidhjes Epirote, një vulë e rrumbullakët balte me simbolin e rrufesë dhembishkrimin ΣΤΡΑΤΑΓΟΥ (estrategut), si dhe 14 copë tesera të rrumbullakëta bronzi (fig.23), që mbanin mbishkrimin ANTIGONEΙΩΝ (Antigonasve). Mendohet se ato mund të kenë shërbyer përvotim. Një numër enësh balte të thyera, një enë bronzi e djegur nga zjarri dhe vegla hekuri të shpërndara në dyshemetë e kthinave të tjera, ringjallnin skenën e bastisjes dhe djegies së shtëpisë nga pushtuesit e qytetit.

Banesa e lëkurëregjësit, u quajt nga Dh. Budina shtëpia e zbuluar prej tij në anën tjetër të rrugës A. Ka planimetri katërkëndëshe  $16.50 \times 12$  m, me një oborr në anënjugore (fig.24 A,B). Një korridor qendror




Fig. 23. Vula e strategut dhe teserat e bronzit me emrin e qytetit Antigoneia.

me gjatësi 11 m dhe gjerësi 4.20 m përrshkon në mes banesën, duke komunikuar në anën lindore me dy kthina të mëdha me pragje guri të punuar. Në dyshemenë e njërsë prej tyre u gjetën gjashtë enë bronzi të djegura nga zjarri dhe disa monedha bronzi. Një shtresë djegie i mbulonte ato, si dëshmi e një fundi tragjik të kësaj banese. Në krahun tjetër të korridorit u zbuluan tri kthina me funksione shërbimi. Ajo që komunikonte me oborrin kishte përmasa  $4.90 \times 4$  m dhe përfaqësonte një punishte të vogël lëkurësh. Kjo dëshmohej nga pesë pitosa të vendosur thellë në dyshemenë e kthinës, në mënyrë që vetëm grykat dilnin mbi sipërfaqen e saj




Fig. 24. “Banesë e lëkurëregjësit” gjatë gërmimit dhe planimetria e saj.



Fig. 25. Pitosat në “Banesën e lëkurëregjësit”.




Fig. 26. Vegla hekuri për punimin e lëkurëve.

(fig.25). Një numër veglash hekuri të gjetura rreth tyre (fig.26), lidheshin me përpunimin e lëkurëve, prandaj Dh. Budina mendoi se banesa i takonte një lëkurëregjësi.

**Banesa e karrocierit**, u quajt nga Dh. Budina njëbanesë e zbuluar prej tij në insulën që shtrihej në veri me atë të banesave të mësipërme (fig.27). Në njerën prej kthinave të saj u gjet veshja prej hekuri e një rrote me diametër 1.10 m (fig.28). Kjo dëshmonte se banorët e Antigonesë i përdornin karrocat për transportin e materialeve nëpër rrugët e gjera të qytetit të tyre.



Fig. 27. "Banësa e karrocierit" gjatë gërmimit.



Fig. 28. Rrota e zbuluar në "Banësën e karrocierit".

### Sektori E

Në pjesën më të lartë të zonës së banuar, disa metra larg murit rrethues të anës lindore, Dh. Budina gërmoi një banesë katërkëndëshe  $25 \times 15$  m (fig.29). Ajo kishte qenë ndërtuar në shek.III p.Kr., duke pasur tri kthina me mure qerpiçi mbi një cokolaturë prej blloqesh guri katërkëndësh. Pas rrënimit të saj, ishte ngritur një banesë



Fig. 29. Banesa nr. 4 me peristikl. Pamja dhe planimetria.

tjetër, e ngjashme nga teknika e ndërtimit me banesat e sektorit C. Në dyshemën e banesës, të mbuluar nga një shtresë hiri, u gjet një pitos i thyer si dhe disa monedha bronzi të Lidhjes Epirote, që dëshmonin të njëjtin fund të dhunshëm, si ai i banesave të tjera të Antigonesë.

### Fortifikimet e qytetit

Muri rrethues i Antigonesë, me gjatësinë prej 3700 m, vjen i treti pas atij të Apollonisë dhe Foinikes. Ndryshe prej tyre, që janë

rezultat i punimeve dhe ndryshimeve qindravjeçare, muri i Antigonesë u ngrit brenda një periudhe të shkurtër sipas një plani të vetëm. Fortifikimet e Antigonesë janë më të ruajturat nga ato të të gjitha qyteteve antike të vendit tonë. Pjesa më e lartë e fortifikimit, akropoli (fig.30), ka një sipërfaqe 3 ha, që ndahet nga një mur prej zonës së banuar. Rëndësinë ushtarake të tij e dëshmon përforcimi i mbrojtjes me shtatë kulla katërkëndëshe me përmasa  $6.5 \times 6.5$  m. Dy prej tyre shohin nga brenda qytetit, gjë



Fig. 30. Akropoli i Antigonesë.

që tregon se akropoli strehonte që në fillimet e tij një objekt të rëndësishëm, siç mund të ishte pallati i mbretit, apo i guvernatit. Akropoli kishte edhe një hyrje, që mund të quhej e fshehtë, për t'u lidhur me rrithinat. Ajo ka qenë vendosur në një kthesë të anës veriperëndimore të murit rrithues dhe kalonte përmes një kulle katërkëndëshe (fig.31).

E gjithë pjesa tjeter e fortifikimit është rrrethuar me një mur të vetëm, të përforcuar me kulla në vendet më të ekspozuara ndaj sulmeve të mundshme të armikut. I tillë është tërë krahu jugor i fortifikimit, ku janë vendosur tri kulla me përmasa  $6.4 \times 7$  m, në një mënyrë që të vinin midis dy zjarresh forcata armike gjatë sulmit (fig.32). Prej tyre




Fig. 31. Hyrja përmes kullës në akropol.

mund të mbrohej nga litobolët (gurëhedhësit) edhe njëra nga hyrjet kryesore të qytetit. Ajo ka qenë vendosur në aksin e rrugës kryesore që përshkonte qytetin nga veriu në jug. Megjithëse ende nuk është e gërmuar, mund të dallohet mënyra e ndërtimit të kësaj hyrjeje, e cila ka një planimetri të ngjashme me portën jugore të qytetit të



Fig. 32. Muri me kulla i anës jugore.



Fig. 33. Hyrja e anës jugore. Pamja dhe planimetria.

## *Qyteti Antik i Antigonesë*

Lisit (Lezhës). Korridori i saj kalonte përmes dy kullave që formonin një bastion të vetëm me përmasa rrëth  $10 \times 10$  m (fig.33 A,B). Një hyrje tjetër, me gjerësi vetëm 1 m gjendej pothuaj në mesin e murit jugor dhe shërbente për daljen e beftë të luftëtarëve gjatë kundërsulmeve (fig.34).

Eshtë zbuluar edhe një tjetër portë kryesore në anën veriore të qytetit. Korridori i saj dallohet si një hapësirë midis

dy krahëve paralelë të murit rrëthues dhe korrespondon me rrugën që futet sot në Parkun Arkeologjik të Antigonesë.

Një element i veçantë i fortifikimit të Antigonesë është muri parambrojtës (proteikisma) i anës jugore, i cili ngrihej në formën e një tarrace rrëth 50 m para murit rrëthues, për të krijuar një pengesë për afrimin e luftëtarëve armiq dhe të makinave luftarake të kohës.



Fig. 34. Hyrja e vogël në murin jugor.

I gjithë muri rrethues i Antigonesë ka qenë ndërtuar në një kohë të shkurtër, gjë që duket edhe nga teknika e njëllojtë në tërë gjatësinë e tij. Në vendet më të ekspozuara ndaj sulmeve muri ka gjerësinë deri 3.80 m dhe ngushtohet deri në 2.20 m në vendet e mbrojtura nga natyra. Ai është i ndërtuar me blloqe gurësh gëlqerorë konglomerati me forma katërkëndëshe, të vendosura në rreshta paralelë me lartësi të barabartë (izodomike) prej 0.40-0.45 m (fig.35). Në strukturën e tij muri përbëhet nga faqja e jashtme dhe e brendshme, si dhe mbushja me gurë të vegjël e dhë midis tyre. Çdo 2.7 m kjo mbushje përshkohet për së gjeri nga parete që lidhin të dy faqet dhe kompaktësojnë të tri pjesët e murit. Atje ku kalon mbi shkëmbinjtë e anës lindore muri është ndërtuar me blloqe me forma poligonale. Ky është një shembull i përdorimit të teknikave të ndryshme të ndërtimit në të njëjtën kohë për arsyet thjesht praktike. Në rastin e mureve me teknikën kuadratike izodomike blloqet silleshin nga gurorja, ku punonte një skuadër e veçantë mjeshtërish, të cilët i nxirrin blloqet në madhësi pothuaj të barabartë. Një skuadërtjetëri transportonte këta blloqe, ndërsa një skuadër e tretë i vendoste në mur. Pra, ishte një proces që do ta quanim “të industrializuar”. Në rastin



Fig.35. Pamje e murit rrethues të anës jugore.

e mureve me teknikë poligonale materiali gjendej në vend, prandaj punonte një skuadër e vetme, e cila synonte të përdorte sa më me ekonomi gurin, duke parapëlqyer format shumëkëndëshe.

Karakteristike për murin rrethues të Antigonesë është ruajtja e tij në të njëjtën lartësi. Arkeologët mendojnë se kjo lidhet me faktin se muri prej blloqesh gëlqerore ka shërbyer si bazament për të ngritur mbi të një strukturë prej qerpiçësh deri në lartësinë 7 m. Kjo mënyrë ndërtimi është e njohur nga muri rrethues i Apollonisë në shek.IV-III p.Kr., por edhe në murin rrethues të agorasë së Butrintit.

Ndërtimi i fortifikimeve të Antigonesë është shoqëruar me ngritjen e fortifikimeve

të tjera në luginën e Drinosit, që formonin një sistem unik mbrojtjeje për Atintaninë e sipërme. Këtë e dëshmon e njëta teknikë ndërtimi e përdorur në fortifikimet e Leklit, Melanit, Ktismatës, etj. Një ndikim më të largët e gjejmë edhe në Lis (Lezhë), ku është zbatuar një planimetri e ngjashme.

### Kisha paleokristiane

Gjatë gjermimeve të vitit 1974 Dh. Budina zbuloi në këndin më juglindor të qytetit një kishë paleokristiane me përmasa  $13.80 \times 4.60$  m. Arkitektura e kishës është e thjeshtë dhe ndërtimi është bërë me gurë

të nxjerrë nga muri rrethues, të lidhur me llaç. Budina e quajti atë trikonka, për shkak të tri absidave që përbyllnin altarin nga ana lindore. Një ikonostas i gurtë, nga i cili është ruajtur vetëm bazamenti, ndante altarin nga naosi me përmasa  $7.30 \times 4$  m. Dyshemeja e altarit është shtruar me një mozaik shumëngjyrësh, që shtrihet në një sipërfaqe eliptike midis dy absidave (fig.36). Ai ndahet në tri panele, të kufizuara nga breza me motive gjeometrike dhe bimore. Paneli qendror përbën figurën e një njeriu me kokë qeni. Ai paraqitet i veshur me një fustanellë mbi kallcat, të cilat janë qarkuar




Fig.36. Mozaiku i kishës së Antigonesë.




Fig.37. Figura njerëzore e mozaikut.

nga lidhëset e opingave (fig.37). Mbi supe ka hedhur një pelerinë të qëndisur, e cila i varet nga dy krahët. Dorën e majtë e ka të ngritur lart, sikur do të godasë një gjarpër të madh me pika, që po e kafshon atë poshtë mjekrës. Skena plotësohet nga një fidan në anën e djathtë dhe një zog me lule në sqep në të majtën. Paneli në absidën

veriore paraqet eukaristinë nëpërmjet një kantari nga dalin bisqe hardhie. Në absidën e kundërt është dhënë një skenë detare me peshq dhe ngjala. Katër mbishkrime të realizuara me mozaik i takojnë personave që e realizuan atë. I pari, pranë euharistikës përkthehet: "Skllavi i zotit, Agathokli, me lutje e bëri". I dyti, mbi figurën njeri-qen, përkthehet: "Skllavi i zotit, Euzomeni... e pagoi nga vetja dhe nga shtëpia". Mbishkrimi i tretë, në krah të figurës është i vështirë të lexohet nga botimi i Dh. Budinës, por mund të dallohet: "...skllavit tënd, priftit Dorotheos dhe skllaves tënde, dhiakes Nika?..për prehjen e Aleksandrit. Zot kujto skllavin tënd Synepus?...". Mbishkrimi i katërt është i palexueshëm nga kopjimi i tij në skicën e botimit.

Figura njerëzore është shpjeguar si Shën Kristofori, që paraqitej si njeri me kokë qeni, ndërsa ndërtimi i kishës është datuar në shek.VI m.Kr.

Në këtë periudhë në territorin e Antigonesë nuk kishte ndonjë vendbanim të rëndësishëm, megjithëse niveli i realizimit të mozaikut dhe vetë mbishkrimet flasin për persona të pasur dhe të kulturuar. Shenja të mëdha djegieje mbi sipërfaqen e mozaikut dëshmojnë se kisha ka qenë shkatërruar, gjashtë gjatë dyndjeve sllave të shek.VI m.Kr.

# *Monumente jashtë Murit Rrethues*

## Nymfeu

Në anën jugore të Antigonesë, rreth 200 m larg murit rrethues, Dh. Çondi pastroi një mur të ndërtuar me blloqe poligonale, me lartësi rreth 3 m, që përforcohej nga kontraforte  $0.50 \times 0.50$  m (fig. 38). Këtyre i korrespondonin pilastrat prej blloqesh guri në një mur të ulët paralel, që shërbën për të mbajtur trarët e një çatie njëujëshe. Kemi të bëjmë, kështu, me një stoa, të ndërtuar jashtë mureve të qytetit. Monumenti është



Fig.38. Nymfeu i Antigonesë.

zbuluar pjesërisht në gjatësinë 70 m, por prania e një burimi uji aty afër, mund të tregojë për një çezmë monumentale kushtuar nimfave. Mënyra e ndërtimit e lidh atë me monumentet e ngritura menjëherë pas themelimit të qytetit.

## Varri monumental

Në shpatin perëndimor të kodrës, rreth 50 m poshtë murit rrethues, u gjet rastësisht një varr monumental (fig.39), i

cili u gërmua më pas nga Dh. Çondi. Ai ka formën tipike të varreve monumentale me një paradhomë të ngushtë dhe një dhomë varrimi katërkëndëshe, të dyja të mbuluara me një qemer cilindrik. Ruhen kanatat e dyerve të gurta që mbyllnin dikur hyrjet e të dy kthinave. Monumenti është ndërtuar me blloqe gurësh katërkëndësh, pa lidhje llaçi. Varre të tillë njihen në disa qendra epirote dhe ilire, si në Kasope, Borsh, Amantia, Bylis, Selcë, etj. Ato ishin ndërtuar për varrimin e personaliteteve të shquara, apo të qytetarëve të pasur



Fig.39. Varri monumental i Antigonesë.

gjatë shek.IV-III p.Kr. Varri i Antigonesë ka qenë ndërtuar në dhjetëvjeçarët e parë pas themelimit të qytetit dhe duhet të ketë qenë grabitur e shkatërruar pas pushtimit të tij. Sidoqoftë, të gjitha materialet e ndërtimit të varrit gjenden në vend dhe është i mundur rindërtimi i tij nga restauratorët.

### **Thesari i monedhave antike**

Në vitin 1975, në perëndim të kodrës së Antigonesë u gjet rastësisht një thesar monedhash antike. Ai ishte groposur brenda një banese të vetmuar antike njëdhomëshe, me përmasa  $3.25 \times 3$  m, prej mure gurësh të lidhur me baltë. Thesari u gjet brenda

një ene qeramike, nën nivelin e dyshemesë prej trualli balte të dhomës. Një shtresë djegieje që mbulonte atë dysheme, përtërinte të njëjtat skena siatotë Antigonesë: ushtria romake kishte bastisur rrëthinat e qytetit dhe pronari i kësaj shtëpize, që gjendej pranë një vreshti, nuk ishte kthyer më për të marrë pasurinë e fshehur. Ajo përbëhej nga 218 copë monedha argjendi, kryesisht të Korkyrës, dhe vetëm një monedhë bronzi e Lidhjes Epirote. Ishte kjo e fundit që saktësonte datën e fshehjes së thesarit në të njëjtën kohë me atë të shkatërrimit të qytetit, në vitin 167 p.Kr.

### **Manastiri i Shën Mërisë në Spile**

Rreth 2 km në lindje të Antigonesë gjendet manastiri i Shën Mërisë. Ai është ndërtuar pranë një shkëmbi konglomerat gëlqeror, i njohur si Spile, për shkak të shpellave karstike, njëra prej të cilave ka qenë banuar nga eremitët.

Kisha ruhet në gjendje të mirë (fig.40) dhe përbëhet nga naosi i tipit në formë kryqi me kupolë, nga narteksi dhe një hajat i ngushtë. Mbi portën e naosit ka një

*Monumente jashtë Murit Rrethues*



Fig.40. Kisha e Manastirit të Shën Mërisë në Spile.

mbishkrim greqisht që tregon se kisha u piktuua në vitin 1634, në kohën e peshkopit Kalist, me kontributin e jeromonakëve Konstantin dhe Joasaf, si dhe të arkondëve të Saraqinishtit. Piktori ka shënuar edhe emrin e vet, Mihaili. Një mbishkrim i dytë, që gjendet mbi portën e pronaosit dhe mban datën 1659, flet për ndërtimin më të vonë

të kësaj pjese të kishës dhe për pikturimin e saj me kontributin e arkondit Joan, kur ishte igumen i Manastirit Partheni.

Pikurat janë të një cilësie të lartë (fig.41) dhe mund të krahasohen me ato të Voskopojës. Gjendja e ruajtjes së tyre është kritike, për shkak të lagështirës që kalon nga kupola dhe muret.



Fig.41. Afresku i pronaosit në Kishën e Shën Mërisë në Spile.

## Gjetje arkeologjike nga Antigoneia

### Sfinksi (fig.42)

Bronz. Lartësia 17.5 cm; gjerësi 17.5 cm.  
Muzeu Kombëtar, Tiranë.


Figurinë që paraqet sfinksin, qenie mitologjike gjysmëgrua dhe gjysmëluan. Në të vërtetë është një këmbë e madhe ene bronzi, e trajtuar në formën e një sfinksi. Modeli ka qenë imituar nga prodhimet greke të kohës, por është realizuar nga mjeshtri



Fig.42. Këmbë  
ene bronzi në  
trajtë sfinksi.

vendës në një zgjidhje mjافت origjinale. Trupi i sfinksit ka pamjen e një gruaje të re, me fytyrë të bukur dhe flokë të krehur lart me tufa të veçuara. Në qafë i dallohet një veshje pa jakë, e stolisur me qëndisje. Poshtë gjoksit trupi i sfinksit ngushtohet menjëherë për t'u transformuar në një këmbë të madhe luani, në përshtatje me funksionin mbajtës të saj. Krahët e sfinksit

kanë qenë punuar veçmas, për t'iu përshtatur ngjitjes pas fundit të enës. Pjesa më e madhe e krahut të majtë ka humbur. Pjesa e prapme e sfinksit është punuar në formë pragu, në mënyrë që të ngjitej me trupin e enës. Ena duhet të ketë pasur edhe dy këmbë të tjera të të njëjtës formë. Ajo u gjet në banesën e quajtur e "Pirros" dhe datohet në gjysmën e parë të shek.II p.Kr.



**Figurinë e Poseidonit (fig.43)**

Bronz, lartësia 14.5 cm.

Muzeu Kombëtar, Tiranë.

Kulti i Poseidonit ka qenë mjaft i përhapur në Epir dhe Ilirinë e Jugut, ku nderohej si perëndi e detyrave, por edhe e tërmeteve. Poseidoni është paraqitur i zhveshur, me mjekër të dendur dhe flokë të gjatë të lagur, sikur posa ka dalë nga deti. Trupi muskulor ka një lëvizje sinusoidale, të krijuar nga mbështetja në tredhëmbëshin e mbajtur me dorën e majtë, në kundërvënie me të majtën që mbante një pjatë. Shprehja ekspressive e fytyrës, gjymtyrët e stërzgjatura jashtë proporcioneve dhe lëvizjet e guximshme të duarve dëshmojnë për një punë lokale të një artisti të talentuar, që e njihte mirë artin bashkëkohor. U gjet në banesën me atrium dhe datohet në gjysmën e parë të shek.II p.Kr.

Fig.43. Figurinë bronzi e Poseidonit.

# *Qendrat e tjera antiqe të Luginës së Drinosit*

## **Kalaja e Leklit**

Fortifikimi antik që mban këtë emër gjendet mbi një kreshtë shkëmbore në juglindje të fshatit Lekël të Tepelenës, pikërisht në vendin ku lugina e Drinosit ngushtohet para se të bashkohet me atë të Vjosës (fig.44). Prej aty kontrollohet drejtpërdrejt rruga natyrore që kalon nëpër shpatin perëndimor të malit të Golikut për në thellësi të luginës së Drinos, por në një



Fig.44. Pamje nga kështjella e Leklit drejt grykave të Antigonesë.

vështrim më të hapur kontrollohet e gjithë gryka e quajtur në antikitet “ngushticat e Antigonesë”, që nga fushat e Tepelenës, deri në bashkimin e lumenit Kardhiq me Drinon.

Fortifikimi me sipërfaqe vetëm një hektar ka qenë parashikuar për vendosjen e një garnizoni të vogël ushtarak që mbikëqyrte lëvizjet nëpër ngushtica. Muri rrethues qarkonte vetëm anët jugore dhe perëndimore të kreshtës, sepse anët e tjera mbroheshin nga rrëpira të pakalueshme. Hyrja gjendet në anën veriore, e maskuar midis shkëmbinjve. Muratura është krejt e ngjashme me atë të Antigonesë. Ka një gjerësi  $3.20\text{ m}$ , me dy faqe prej blloqesh katërkëndëshe me lartësi të barabartë prej  $0.45\text{ m}$ , ndërsa mbushja është bërë me gurë të vegjël midis tyre. Në mbylljen e hapësirave midis shkëmbinjve ka qenë përdorur edhe muratura poligonale (fig.45).

Sipërfaqja brenda mureve ka pak vende të sheshta përbanim. Nuk janë bërë gërmime dhe nuk janë gjetur objekte të rëndësishme arkeologjike.



Fig.45. Pjesë e murit antik në kështjellën e Leklit.

Kështjella ka qenë ndërtuar në të njëjtën periudhë me Antigononë, rreth vitit 295 p.Kr. dhe bënte pjesë në sistemin e fortifikimit që u krijuau përmes mbrojtjen e saj.

### Kështjella e Kardhiqit

Kjo kështjellë zotëron luginën e mesme të lumit të Kardhiqit, që përbën një rrugë natyrore përmes kaluar nga lugina e Drinosit përmes pellgun e Sarandës. Ka qenë kjo rruga që përshkoi vëllai i Agronit, Skerdilaidi, në krye të një ushtrie ilire prej 5000 luftëtarësh përmes sulmuan në befasi ushtrinë epirote pranë Foinikes në vitin 232 p.Kr.

Kështjella që përfshin pjesën e sipërme të kodrës është një ndërtim i shek. XIV, i kohës së sundimit të familjes feudale të Zenevisëve. Është një kështjellë tipike garnizoni, në formë të përafërt pesëkëndëshe, me perimetër rreth 450 m dhe me pesë kulla në secilin kënd (fig.46). Hyrja përmes kullës katërkëndëshe të anës lindore. Korridori i saj mbulohet me një qemer cilindrik, mbi të cilin vazhdon kati i dytë i kullës, i lidhur me një palë shkallë

me vetë korridorin. Edhe dy kullat e tjera katërkëndëshendahen në dy kate nga qemerë cilindrikë. Katet e poshtme ndriçohen nga frëngji të ngushta përmes harkëtarëve. Dy kullat e tjera janë pesëkëndëshe dhe dëshmojnë përmes një rindërtim të shek.XIX, kur kështjella u pushtua nga Ali Pashë Tepelena. Një rresht kthinash të mbuluara me qemer, që kalojnë përgjatë mureve perëndimore dhe veriore, kanë shërbyer përmes qëndrimin e luftëtarëve. Disa ndërtime në pjesën tjetër, duke përfshirë edhe një stere katërkëndëshe  $20 \times 4$  m, e mbuluar me qemer, kanë shërbyer gjithashtu, përmes garnizonin.

## *Qendrat e tjera antike të Luginës së Drinosit*




Fig.46. Kështjella e Kardhiqit. Planimetria.

Në anën perëndimore të kodrës, rrreth 50 m larg mureve mesjetare, ruhet përrreth 150 m një mur antik me blloqe gëlqerore katërkëndëshe. Një trakt tjetër muri ruhet në anën veriore, duke përvijuar planimetrinë e një kështjelle me sipërfaqe rrreth 3 ha. Teknika e ndërtimit është e ngjashme me atë të Melanit dhe e daton ndërtimin e kështjellës në gjysmën I të shek.IV p.Kr. Ka mendime se kështjella antike e Kardhiqit mund të identifikohet me Fanoten, një fortifikim epirot, që luajti një rol në ndeshjen ndërmjet romakëve dhe

maqedonëve. Në të vërtetë Fanote sipas Tit Livot (XLIII, 21, 4 dhe 23, 1) ishte një qendër më e rëndësishme se kështjella e Kardhiqit dhe gjendej në jug të luginës së Drinosit, përtej kufirit të sotëm shtetëror.

### **Kështjella e Labovës së Madhe**

Rreth 500 m në jug të fshatit Labovë e Madhe ngrihet një shkëmb i zhveshur, që lidhet nga veriu me shpatin e malit Bureto, ndërsa nga jugu pritet në një rënie të thiktë drejt shtratit të lumit Suhë (fig.47). Një fortifikim antik rrrethon pjesën më të lartë të shkëmbit në një sipërfaqe rrreth 1.4 ha, duke lënë të hapur pjesën jugore të mbrojtur nga natyra (fig.48). Një bastion trapezoidal  $9.3 \times 8$  m përforcon afrimin drejt kështjellës nga ana e qafës ku lidhet me shpatin e malit. Pas disa kthesave të murit, që zbret përgjatë pjerrësisë së faqes shkëmbore, gjendet hyrja me një korridor të harkuar, që përforcohet në anën e majtë nga një bastion gjysmërrethor me diametër 8.25 m. Më tej muri zbret edhe përrreth 50 m të tjera dhe pastaj ndërpritet. Blloqe gurësh të transportuar, por të pavënë në mur, dëshmojnë se ndërtimi i mëtejshëm i murit ka qenë ndërprerë, ndërsa kështjella nuk ka qenë përfunduar që në lashtësi. Kjo lejon edhe të këqyret teknika e ndërtimit, që është e veçantë në krahasim me qendrat e tjera antike të luginës së Drinosit. Në tërë gjatësinë e tij muri paraqet një lloj tarrace



Fig.47. Pamje nga kështjella e Labovës drejt grykës së Suhës.




Fig. 48. Planimetria e kështjellës së Labovës.




Fig. 49. Pamje e murit rrethues të kështjellës së Labovës.

## *Qendrat e tjera antike të Luginës së Drinosit*

me lartësi deri në 5 m (fig.49), të ndërtuar me rrasha të mëdha guri të nxjerra nga shtresat gëlqerore, e cila niveloonte terrenin në një gjerësi deri në 3 m deri te shkëmbi. Mbi këtë rrugëkalim për rojat ka qenë ndërtuar një gjoksmburojë me gjerësi 1 m dhe lartësi deri 2 m.

Në brendësi të kështjellës ruhen gjurmë baneshash që kanë qenë ndërtuar me mure të ulëta në formë cokoli, mbi të cilat ngriheshin parete me thupra të lyera me baltë, siç dëshmojnë mbetjet e tyre pas djegies. Në sipërfaqen shkëmbore të gërryer nga erozioni gjenden fragmente qeramike që e datojnë fillimin e banimit në këtë kështjellë në shek.V p.Kr. Mungesa e qeramikës më

vonë se shek.II p.Kr. dëshmon se edhe kjo kështjellë ka pasur fatin e Antigonesë.

## **Qyteti Antik në Bregun e Melanit**

Në vargun e kodrave që kufizojnë nga juglindja luginën e Drinosit, bie në sy Bregu i Melanit (fig.50), një platformë shkëmbore e mbuluar nga një pyll qiparisash, e cila shkëputet përmes një qafe të ulët nga shpati i malit të Buretos. Ana veriore e saj ndërpritet nga gremina të pakalueshme, ndërsa dy anët e tjera ngjiten me vështirësi, për shkak të pjerrësisë së madhe të terrenit. Pjesa e sipërme e kodrës, relativisht e rrafshët, ka qenë rrethuar në lashtësi prej



Fig. 50. Pamje e Bregut të Melanit.




Fig. 51. Planimetria e qytetit antik në Bregun e Melanit.

një muri në gjatësi rreth 1100 m (fig.51). Sipërfaqja prej rreth 8 ha dëshmon për një vendbanim të karakterit qytetar.

Sondazhet arkeologjike të bëra nën drejtimin e S. Muçajt, kanë dëshmuar fillimet e jetës në këtë vendbanim që në periudhën fundore të epokës së bronzit dhe në fillim të epokës së hekurit (shek.XIII–IX p.Kr.).

Kjo provohet nga një shtresë që përbante qeramikë të thjeshtë, të punuar pa çark, me forma të ngjashme me ato të tumave të luginës së Drinosit, apo të qendrave ilire-epirote të asaj kohe. Me të lidhet edhe një trakt muri rrëthues i gërmuar në anën perëndimore. Ai ka gjërësinë 2.80 m dhe ruhej deri në lartësinë 1.50 m.

### Muri rrëthues i periudhës antike

Monumenti më i rëndësishëm i këtij vendbanimi është muri rrëthues i periudhës antike, i cili ruhet më mirë në anën juglindore (fig.52). Atjeruhën tri kulla katërkëndëshe që kontrollonin shtigjet e afritit të mundshëm të armikut. Më tej muri ndërpritet sepse rëniet e pakalueshme shkëmbore e bënin të panevojshëm përdorimin e tij. Në anën



Fig. 52. Muri antik në anën juglindore të Bregut të Melanit.

perëndimore muri shfaqet përsëri për disa dhjetëra metra dhe ka qenë përforuar me një kullë katërkëndëshe me përmasa  $6.10 \times 5$  m. Në tërë këtë gjatësi muri është ndërtuar me blloqe të mëdha gëlqerore, me forma poligonale dhe ngjason me muret e të njëjtit lloj nga Foinike, Butrinti, apo Çuka e Ajtojt.

Pas një shkëputje mbi greminën e anës veriore muri shfaqet në anën e ngushtë lindore, ku dallohen gjurmët e tri kullave katërkëndëshe me përmasa  $6 \times 6.30$  m. Këtu muri ndryshon tërësisht nga pjesa e mëparshme porsa i përket teknikës së ndërtimit. Ai përbëhet nga blloqe gëlqerore me forma katërkëndëshe, të vendosura në rreshta me lartësi të barabartë (izodomik) prej 0.46 m. Gjerësia e murit prej 3.20 m përbëhet nga dy faqe prej blloqesh të punuar dhe mbushjes prej gurësh të vegjël. Këto veçori e lidhin këtë periudhë të dytë ndërtimi me kohën e ndërtimit të Antigonesë.

Në rrafshet e sipërme të anës veriore të vendbanimit, ku ka burime natyrore uji të pijshëm, ruhen gjurmë të ndërtesave me karakter shoqëror. Në anën jugore ruhen themelët e një ndërtese shoqërore me planimetri katërkëndëshe, si dhe gjurmët e një mozaiku të kohës romake.

### **Ndërtimë të tjera**

Në anën perëndimore ruhen trakte të një muri të ndërtuar me gurë të vegjël të lidhur me llaç (fig.53). Ai ka gjerësi 1.70



Fig. 53. Muri i antikititetit të vonë në Bregun e Melanit.

m dhe ruhet në lartësi deri 2.70 m. Më tej, në anën jugore, ruhen trakte të tjera të tij deri në lartësinë 5.60 m, si dhe një kullë katërkëndëshe. Teknika e ndërtimit e lidh këtë mur me periudhën e Justinianit (527–565 m.Kr.), kur u rindërtuan një numër i madh fortifikimesh në provincën e Epirit të Vjetër, ku bënte pjesë edhe lugina e Drinosit. Kësaj periudhe i takon edhe një shtresë që përbante materiale qeramike të shek.VI m.Kr., si dhe disa fragmente arkitekturë tipike për kishat paleokristiane.

Në anën jugperëndimore të kodrës dallohet edhe një mur më i vonë, që i ngjitet atij të periudhës së Justinianit. Ai është ndërtuar duke përdorur materiale nga muret më të hershme: blloqe, gurë të thyer dhe copa tjegullash, të lidhur me llaç gëlqereje. Me të njëjtën teknikë ndërtimi



Fig. 54. Ujësjellësi në Bregun e Melanit.

është ndërtuar edhe një ujësjellës në formën e një muri me gjerësi 0.80 m dhe lartësi deri 2.50 m (fig.54). Në pjesën e sipërme ka një kanal ku kalon një tubacion qeramike. Ka mundësi që këto ndërtime t'i takojnë periudhës mesjetare, shek.XII–XIV.

Ndërtimet më të vona në Bregun e Melanit përfaqësohen nga një kishë e rrënuar pasbizantine e shek.XVII, si dhe nga teqeja bektashiane e Melanit.

### Emri i lashtë i qytetit

Qyteti antik në Bregun e Melanit ka qenë qendra kryesore e luginës së Drinosit para themelimit të Antigonesë. Ai ka qenë ndërtuar në gjysmën I të shek.IV p.Kr. në kohën e lidhjeve të ngushta me Molosinë dhe Kaoninë, siç dëshmohet

nga teknika e ndërtimit të mureve rrethuese. Ky qytet nuk përmendet asnjëherë në burimet historike krahas Antigonesë dhe identifikimi i tij me Omfalion, të përmendur nga gjeografi grek i shek.II m.Kr., Ptolemeu, nuk mund të jetë i sigurt. Gjithashtu, nuk është i sigurt edhe identifikimi i qytetit të periudhës së Justinianit dhe atij të periudhës mesjetare me Justinianopolin e përmendur nga Prokopi i Cezaresë, apo Hadrianopolin mesjetar.

### Hadrianopoli

Në mesin e luginës së Dropullit, përballe Bregut të Melanit, gjendet qyteti antik i Hadrianopolit, i mbuluar tërësisht nga aluvionet e lumit Drino. Kërkimet gjeofizike kanë dëshmuar se ai shtrihet në një sipërfaqe rreth 16 ha dhe përshkohet nga një rrjet kuadratik rrugësh (fig.55). Gërmimet arkeologjike, të drejtuara nga A. Baçe, kanë nxjerrë në drithë teatrin antik të qytetit, në një zonë qendrore, që duhet të jetë forumi.

Teatri i përket tipit të njohur romak të ndërtuar në një terren të sheshtë (fig.56), me shkallaren e mbajtur nga një mur gjysmërrethor me diametër 57.23 m dhe lartësi që arrinte 15 m (fig.57). Pesë mure

## Qendrat e tjera antiqe të Luginës së Drinosit




Fig. 55. Gjurmë të ndërtimeve antiqe në Hadrianopol sipas kërkimeve gjeofizike.




Fig. 56. Teatri antik i Hadrianopolit. Planimetria.

të tjera koncentrike me të jashtmin dhe 11 mure në formë rrezesh formojnë strukturën e mbushur me dhë, mbi të cilën janë vendosur ndenjëset për spektatorët. Ato janë përgatitur prej blloqesh gëlqerore me gjatësi 1-2 m, lartësi 0.37 m dhe gjerësi 0.60 m. Kishte gjithsej 24 radhë ndenjësesh të ndara në mes nga një rruginë për lëvizjen e spektatorëve. Pesë shkallina tërthore shërbenin për ngjitjen e tyre për në vendin e ndenjes. Hyrja për në teatër bëhej nga dy porta ballore në anët e skenës, nëpërmjet korridoreve të mbuluara me qemerë, që çonin drejt orkestërës, apo shkallëve që ngjiteshin në krah të murit perimetral

(fig.58). Dy hyrje të tjera ishin krijuar nga prapa shkallares, nëpërmjet shkallëve me gjerësi 2 m, të ngjitura pas murit perimetral. Sipas formës dhe përmasave të shkallares, llogaritet që aty mund të uleshin rreth 3500–4000 spektatorë.

Orkestra e teatrit ka formën tipike të një treçerek rrëthi me diametër 15 m. Ajo ka qenë shtruar me pllaka katërkëndëshe guri gëlqeror, që ruhen pjesërisht (fig.59). Skena me përmasa  $26.12 \times 12.34$  m përbëhet nga një tribunë e ulët (*pulpitum*) me lartësi 0.80 m, pas së cilës ngrihej muri i skenës (*frons scenae*), që e ndante nga prapaskena (*postscaenium*).



Fig. 57. Muri perimetral i teatrit.



Fig. 58. Pamje e teatrit të Hadrianopolit.

## *Qendrat e tjera antike të Luginës së Drinosit*



Fig. 59. Pamje nga shkallarja e teatrit.

Gërmimet kanë dëshmuar se teatri ka qenë ndërtuar në shek.II m.Kr., mbi një terren të banuar që nga shek.I m.Kr. Hyrjet e tij orientoheshin nga verilindja, ku gjendej një hapësirë publike, ndoshta forumi. Mure të monumenteve të tjera janë zbuluar në anën lindore të këtij sheshi, por ende nuk është përcaktuar funksioni i tyre (fig.60).

Të gjitha këto ndërtime lidhen me qytetin e Hadrianopolit, të themeluar gjatë sundimit të perandorit Hadrian (117–138 m.Kr.), mbi një qendër më të hershme të krijuar buzë rrugës, që përshkonte luginën e Drinosit

në atë kohë. Emri i qytetit ndeshet për herë të parë në një Tabula Peutingeriana, një udhërrëfyes i shek.IV m.Kr., por që i referohet gjendjes së një shekulli më parë. Ai përfaqëson stacionin e tretë në rrugën nga Apollonia në Nikopolis, që kalonte më parë në Amantia.

Gjatë gërmimeve arkeologjike janë vërtetuar edhe dy periudha më të vona ndërtimi në terrenet rreth teatrit. Një numër muresh që u ngritën me materialet e shkulura nga teatri, kanë qenë ndërtuar në sheshin para tij në shek.IV–VI m.Kr. Kjo



Fig. 60. Pamje e gërmimeve në sheshin para teatrit.

lidhet me periudhën e antikitetit të vonë, kur shfaqjet teatrale u ndaluan dhe teatrot u prishën. Hadrianopoli përmendet në këtë kohë nga Prokopi i Cezaresë (De aed. IV, 1, 36) si një qytet i rindërtuar nga perandori

Justinian (527–565 m.Kr.), i cili ia ndërroi edhe emrin në Justinianopolis. Një shekull më vonë (viti 625 m.Kr.) Hadrianopoli përmendet përsëri me emrin e vjetër në burimet kishtare, si qendër peshkopate. Disa

## *Qendrat e tjera antiķe të Luginës së Drinosit*

ndërtime më të vona dhe me cilësi të dobët i takojnë periudhës mesjetare dhe mund të lidhen me përmendjen e Hadrianopolit si qendër peshkopate në vitin 869.

### **Kështjella në Selo**

Fundi jugor i luginës së Drinosit lidhet me pellgun e Sarandës nëpërmjet një rrugë natyrore që kalonte nëpër luginën e përroit të Klisharit, për të dalë në krye të luginës së lumbit të Leshnicës, që përbënte në antikitet një nga bashkësitë (koinon) kaone me qendrat e fortifikuara në Malçan, Rripës dhe Grazhdan. Nga ana e luginës së Drinosit kjo rrugë kontrollohej në kohën antiķe nga kështjella e Selos, që ngrihet mbi një lartësi shkëmbore në afërsi të fshatit Selo të Dropullit. Muri rrethues prej blloqesh gëlqerore me forma katërkëndëshe (fig.61) ndiqet përgjatë faqes veriore, ku ka dy kulla



Fig. 61. Pjesë e murit rrethues në Selo.

katërkëndëshe. Në faqen perëndimore ruhet gjithashtu një trakt 71 m i gjatë i murit rrethues, si dhe një kullë katrore me brinjë 6.90 m. Faqet e tjera përfundojnë në rënie të thikta, të pakalueshme, ku rrethimi me mure ka qenë i panevojshëm.

Teknika e ndërtimit të murit rrethues me përdorim të shpeshtë kullash është tipike për gjysmën II të shek.IV p.Kr. Gjetjet arkeologjike në truallin e kështjellës tregojnë se ajo ka qenë braktisur në shek. II p.Kr., me sa duket për të njëjtat arsyе si Antigoneia. Në shek.VI m.Kr. kështjella ka qenë fortifikuar vetëm në rrafshet e sipërme të saj me një mur me gurë të vegjël të lidhur me llaç.

### **Paleokastra**

Gjatë viteve 1974 – 1976 A. Baçe kreu gërmime arkeologjike në kështjellën e Paleokastrës, që gjendet në vendin e takimit të lumbit Drino me lumin e Kardhiqit, përballë grykës së Antigonesë (fig.62). Në lashtësi kjo ishte pika strategjike e takimit të dy rrugëve natyrore: e asaj kryesore, që përshkonte nga veriu në jug luginën drejt Molosisë dhe e degëzimit të saj për në qafën e Skërficës, drejt Kaonisë. Atë e pat vizituar së pari majori anglez U. M. Lik, i cili e datoi ndërtimin e saj në mënyrë korrekte në antikitetin e vonë. Ai na njofton se rrënojat quheshin nga vendësita me emrin Drinopol. Pak vjet pas tij, udhëtarë anglez H. Holland e përshkruan Paleokastrën



Fig. 62. Pamje e kështjellës së Paleokastrës.

si një fortesë të ndërtuar në rrafshinë, ku qenë përdorur tulla të kohës romake. Ishte anglez edhe arkeologu i parë që e vizitoi Paleokastrën para Luftës II Botërore, N. Hamond, i cili botoi një përshkrim të formës katërkëndëshe të fortifikimit dhe të teknikës së ndërtimit të tij.

Gërmimet dhe studimet e A. Baçes përcaktuan shtrirjen e kështjellës si një trapez i rregullt me bazën 113.5 m, brinjët anësoreme 92.5 m secila dhe brinjënesi përmë 90.5 m (fig.63). Brenda saj përfshihej një

sipërfaqe prej gati 1 hektar, e mjaftueshme për një kohortë të një legjioni romak (1000 ushtarë). Muret rrethuese përforcohen nga 14 kulla me forma katërkëndëshe përgjatë brinjëve dhe dy skajeve lindore, ndërsa në formë të rrumbullakët në dy skajet e tjera.

Hyrja kryesore për në kështjellë u zbulua në mesin e anës perëndimore, ku kalonte edhe rruga kryesore gjatë sundimit romak–bizantin. Korridori i saj me gjerësi 2.90 përfaqësohet nga vetë gjerësia e murit prej 2.30 m. Porta ka qenë dyflegërshe, siç

## Qendrat e tjera antiqe të Luginës së Drinosit





Fig. 63. Planimetria e kështjellës së Paleokastrës.

provohet nga ruajtja e blloqeve me gropëzat për boshtet e tyre në të dy anët e hyrjes. Ruhen gjithashtu, edhe gjurmët e vrimave ku kalonte katarahu (trari që përforconte nga prapa portën e mbyllur). Mbulimi i hyrjes ka qenë bërë, sigurisht, me qemer, nga i cili nuk ruhen gjurmë (fig.64). Dy kulla katërkëndëshe dykatëshe mbroni këtë hyrje, duke mundësuar edhe ngjitjen përmes tyre për në shtegun e rojeve.

Një hyrje e dytë me gjerësi 1.65 m gjendet në anën veriore, e mbrojtur nga një kullë katërkëndëshe pranë saj. Hyrja e tretë, në anën jugore, ka qenë kryesisht një hyrje

shërbimi, për marrjen e ujit nga lumi aty afër.

Vihet re se të katër hyrjet korrespondojnë me akset kryesore të kështjellës dhe dëshmojnë se brenda saj ishte zbatuar një sistem ortogonal i rrugëve. Kjo duket edhe nga zbulimi i disa mureve të ndërtesave më të hershme gjatë gërmimit të bazilikës në anën lindore të qytetit, të cilat janë orientuar rigorozisht sipas atyre akseve.

Në muret e kështjellës janë vënë re dy periudha ndërtimi. Në ndërtimin fillestar të saj, që i takon dhjetëvjeçarit të parë të shek.IV m.Kr., ato janë ndërtuar me gurë




Fig. 64. Hyrja kryesore e kështjellës. Plan dhe rikonstruksion ideal.

të vegjël e mesatarë, shpesh të punuar me forma katërkëndëshe dhe të lidhur me llaç gëlqereje (fig.65). Në periudhën e dytë që i takon gjysmës I të shek.VI m.Kr., në rindërtimin e mureve në disa vende të dëmtuara nga koha dhe luftërat janë përdorur gurë të vegjël, që përforcohen çdo 0.70 m nga breza tullash prej katër deri gjashtë rreshta tullash, të njojur si *opus mixtum*.

Gërmimet përgjatë mureve rrrethuese në anën e brendshme zbuluan një rresht kapanonesh për strehimin e ushtarëve. Ato kishin formë katërkëndëshe me përmasa  $11 \times 4.50$  m dhe ishin ndërtuar me mure guri dhe dysheme prej trualli balte, tipike për kështjellat ushtarake romake.

Në anën lindore të kështjellës u gërmua një bazilikë paleokristiane (fig.66). Salla qendrore (naos) me përmasa  $13.85 \times 11.43$  m ndahet në tri nefë, ku qendrori ka gjerësi  $5.23$  m. Nga lindja naosi mbyllët me dy absida: në nefin qendror dhe në atë jugor. Nga perëndimi gjendet narteksi me përmasa  $11.43 \times 3.40$  m, të cilit i bashkëngjitet edhe një kthinë tjetër katërkëndëshe me funksione shërbimi. Ndërtimi ka qenë i thjeshtë dhe të vetmet zbulurime janë fragmentet arkitektonike prej mermeri të bardhë që i përkisnin ikonostasit. Në bazë të stilit të punimit të tyre bazilika duhet të jetë ndërtuar në shek.V m.Kr.

Një kishë tjetër u zbulua rrreth  $100$  m jashtë mureve të kështjellës, në anën jugore të saj. Ajo ka përmasa  $8.40 \times 4.60$  m me një narteks të vogël që paraprin naosin, i cili përfundon me një absidë të thjeshtë. Dyshemeja e naosit është e shtruar me tulla të mëdha, të zbuluruara me kryqe dhe shenja të tjera simbolike. Në mes tyre ishte vendosur pllaka ku nguliteshin këmbët e altarit. U gjetën pjesë të tij, si dhe të ikonostasit, të gjitha

## *Qendrat e tjera antiqe të Luginës së Drinosit*



Fig. 65. Pamje e një pjese të murit rrethues.




Fig. 66.  
Planimetria  
e bazilikës  
paleokristiane në  
Paleokastër.

të punuara prej mermeri të bardhë. Në dysheme u gjetën edhe copa nga afresket që zbukuronin dikur muret e kishës. Këto gjetje e vendosin ndërtimin e kësaj kishe në shek. V–VI m.Kr.

Pranë kësaj kishe u gjet një varr monumental në formë dhome, i mbuluar me qemer cilindrik, i cili përbante tri skelete me kokë nga Lindja. Një numër i madh varresh u gjetën përgjatë murit rrethues në këndin verilindor dhe atë jugperëndimor të kështjellës. Ato ishin të ndërtuara me pllaka guri, apo tjegulla dhe të gjitha të

orientuara lindje – perëndim, me kokën e të vdekurit nga Lindja. Ato nuk përmbanin objekte, veçori e varrimeve të shek.IV–VI m.Kr., kur është përdorur kështjella.

Gjatë gërmimeve u gjet një numër i madh fragmentesh qeramike që datohen në shek. IV–VI m.Kr, por shumë pak sende metalike. Kjo provon se kështjella ka qenë braktisur gradualisht dhe njerëzit që e banonin kanë marrë pothuaj gjithçka me vete.

Në qendër të kështjellës u gjet një gurmiliar i periudhës së perandorit Dioklecian (284–305 m.Kr.), që provonte se para ndërtimit të kështjellës aty gjendej një stacion i rrugës romake. Një mbishkrim i dytë u gjet i ripërdorur në pragun e hyrjes së bazilikës së kështjellës. Ai përbante dy mbishkrime në latinisht. I pari i kushtohet perandorit Licin (308–324 m.

Kr.) nga guvernatori i provincës së Epirit të Vjetër, Valer Kasiani. I dyti i kushtohet bashkësundimtarit të tij, Konstantinit të Madh (306–337 m.Kr.), nga një guvernator tjetër i Epirit të Vjetër me emrin Jul Lepidi. Ky mbishkrim që lidhet, sigurisht, me ndërtimin e kështjellës, datohet në vitet 311 – 324, kur të dy dy perandorët bashkësunduan. Mbishkrimet nuk përmenden emrin e kështjellës, i cili nuk ndeshet në burimet historike. Është e vështirë ta identifikojmë atë edhe midis emrave të kështjellave të Epirit të Ri të rindërtuara nga Justiniani, që përmenden në listën e Prokopit të Cezaresë. Pas braktisjes së kështjellës gjatë dyndjeve sllave të mesit të shek.VI m.Kr., emri i kështjellës u harrua dhe rrënojat gjatë mesjetës u quajtën Paleokastër, që do të thotë “Kështjellë e Vjetër”.



Fig. 67. Antigoneia e parë nga larg.



Fig. 68. Banesë me peristil, Antigone.



Fig. 69. Urë mesjetare mbi lumin Drinos.



Fig. 70. Banesë në Saraqinisht.

*Qendrat e tjera antiķe të Luginës së Drinosit*



Fig. 71. Motive mitologjike në muret e banesës në Saraqinisht.



Fig. 72. Festa e shtegtitmit në Antigone, maj 2009.



Fig. 73. Afresk në Kishën e Shën Mërisë në Spile.



Fig. 74. Gjirokastra e parë nga larg.



Fig. 75. Shpella e eremitëve. Spile, Saraqinisht.

# Fjalor

- |                |   |
|----------------|---|
| Agora          | - sheshi kryesor i qytetit, ku gjendeshin ndërtesat publike |
| Akropol        | - pjesa më e lartë, e fortifikuar e qytetit                 |
| Akuadukt       | - ujësjellësi me rrjedhje të lirë me kanal mbi harqe        |
| Apsidë         | - nishe harkore në murin lindor të kishës, pas altarit      |
| Bastion        | - dalje e murit rrethues në formë kulle                     |
| Bazilikë       | - kishë me tri ndarje të brendshme me arkada                |
| Eukaristia     | - kantar me degë hardhie, si simbol i përjetësisë           |
| Insula         | - bllok banesash i ndarë nga rrugë                          |
| Izodomik       | - mur me blloqe gurësh me rreshta me lartësi të njëjtë      |
| Kantar         | - kupë me dy vegje vertikale                                |
| Koinon         | - bashkësi qytetesh e fshatash e tipit republikan           |
| Naos, nef      | - ndarje e brendshme e kishës                               |
| Narteks        | - kthina e mbyllur para hyrjes në nefin qendror të kishës   |
| Nimfë          | - genie mitologjike, zanë e pyllit dhe e ujërave            |
| Nymfé          | - çezmë monumentale kushtuar nimfeve                        |
| Orkestër       | - shesh rrëthor para skenës së teatrit                      |
| Paleokristiane | - periudha e hershme e krishterë (shek.IV-VI m.Kr. )        |
| Peristil       | - hajat me kolona, që qarkon oborrin qendror                |
| Pilastër       | - shtyllë e mbështetur në mur                               |
| Pitos          | - enë e madhe qeramike për ruajtjen e prodhimeve            |
| Prytaneion     | - ndërtesa e nëpunësve kryesorë të koinonit                 |
| Pulpitum       | - tribuna e ulët në teatrin romak, si proskenë              |
| Skenë          | - sfondi arkitekturor i teatrit                             |
| Strateg        | - nëpunësi që drejtonte ushtrinë e koinonit                 |
| Stoa           | - shëtitore e mbuluar                                       |

## Literatura

- A. Baçe, Vështrim mbi qendrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos (Gjirokastër), *Monumentet*, 4, 1972.
- A. Baçe, Gërmimet arkeologjike të vitit 1982 (Sofratikë), *Iliria*, 2, 1983.
- A. Baçe, Kështjella e Paleokastrës, *Iliria*, 2, 1981.
- A. Baçe, G. Paci, R. Perna, *Hadrianopolis. Il Progetto TAU*, Universita di Macerata, 2007
- Dh. Budina, Antigoneia, *Iliria*, 2, 1972.
- Dh. Budina, Mozaiku i trikonkës paleokristiane të Antigonesë, *Iliria*, 7-8, 1977-1978.
- Dh. Dhamo, Figura antropozoomorfe e mozaikut të Antigonesë, *Monumentet*, 1, 1981.
- N. G. L. Hammond, *Epirus*, Oxford, 1964.
- P. Cabanes, M. Korkuti, A. Baçe, N. Ceka, *Harta Arkeologjike e Shqipërisë*, Tirana, 2008.
- S. Muçaj, E. Hobdari, Teqeja e Melanit, *Candavia*, 2, 2005.
- Sh. Gjongecaj, Dy thesare monedhash antike, *Iliria*, 1, 1990.

### Shënim:

Figura 1 dhe 29 janë të Alket Islamit.

Figura 7 është marrë nga P. Franke, *Die Antike Münze*, München, 1972.

Figurat 37, 38, 41 janë marrë nga Engjell Serjani.

Figurat 4 dhe 6 janë nga botime të ndryshme.

Figurat nr.8, 11, 17, 48, 61, 63, 64, 66 janë marrë nga artikujt e A. Baçes.

Figurat nr.12 B, 13 B, 15 B, 16 B, 18, 19, 21 B, 22, 23 – 29, 31, 33 B, 37, janë marrë nga artikujt e Dh. Budinës.

Figurat nr.44, 45, 47, 49, 50, 52 – 54 janë marrë nga S. Muçaj.

Figurat nr.5, 14, 23 b, 42, 43 janë marrë nga katalogu “Schätze aus dem Land der Skipetaren”, Mainz, 1987.


Fotot e tjera janë të autorit.

# Përm&gt;jta


Falënderim	3
NJË EMËR NË KËRKIM	4
PIRRO DHE ANTIGONA	6
Legjendat	6
Eakidët	7
Pirro – hapat e parë	9
Pasardhës i Aleksandrit të Madh	10
Burrë shteti dhe diplomat	13
Ambicjet përtej mundësive	15
Vitet e fundit	17
Figurë e shqar e antikitetit	20
LUGINA E DRINOSIT NË ANTIKITET	22
Popullsia dhe ngjarjet	22
Rrugët antike	22
Emri antik dhe popullsia	23
Atintanët dhe antigoneasit	24
Fundi i Antigonesë	26
QYTETI ANTIK I ANTIGONESË	28
Pamja e qytetit antik	28
Agoraja	28
Stoa	30
Prytaneioni	32
Banesat e qytetit	33
<i>Sektori B</i>	33
<i>Banesa me peristil</i>	34
<i>Banesa e artizanit</i>	34

<i>Banesa e Pirros</i>	35
<i>Sektori C</i>	37
<i>Banesa e strategut</i>	37
<i>Banesa e lëkurëregjësit</i>	38
<i>Banesa e karrocierit</i>	40
<i>Sektori E</i>	40
 Fortifikimet e qytetit	41
Kisha Paleokristiane	46
Monumente jashtë murit rrighthues	48
Nymfeu	48
Varri monumental	48
<i>Thesari i monedhave antike</i>	49
<i>Manastiri i Shën Mërisë në Spile</i>	49
Gjetje arkeologjike nga Antigoneia	52
 QENDRAT E TJERA ANTIKE TË LUGINËS SË DRINOSIT	54
Kalaja e Leklit	54
Kështjella e Kardhiqit	55
Kështjella e Labovës së Madhe	56
Qyteti antik në Bregun e Melanit	58
Hadrianopoli	61
Kështjella në Selo	66
Paleokastra	66
 Fjalor	76
Literatura	77


# Botime nga Shtëpia Botuese *Migjeni*




Shqip




Anglisht




Shqip




Anglisht




Shqip




Anglisht




Frëngjisht




Italisht




Shqip




Anglisht




Frëngjisht




Gjermanisht




Anglisht



Italisht




Greqisht




Greqisht




Shqip




Shqip




Anglisht




Shqip




Shqip



Shqip



Shqip



Shqip



Çmimi 1000 lekë / 9 €

A standard linear barcode used for product identification and pricing.

9 789995 671860